



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES SË JASHTËZAKONSHME TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS
SË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 28 QERSHOR 2018**

**SA VANREDNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 28. JUNA 2018. GODINE**

**QERSHOR - JUN
2018**

Rendi i ditës

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Dnevni red

1. Prvo razmatranje Nacrt zakona o Posebnoj komori Vrhovnog suda u vezi pitanja Kosovske agencije za privatizaciju.

Mbledhjen e drejtoi nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Të nderuara zonja deputete

Zotërinj deputetë,

I nderuar kryeministër,

Të nderuar ministra të Kabinetit qeveritar,

Konstatoj që në sallë kemi kuorum të mjaftueshëm, ju lus që t'i zini vendet.

I hap punimet e seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të caktuar nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare, me kërkesë të kryeministrit të Republikës së Kosovës, zotit Ramush Haradinaj, me këtë rend dite:

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit numër 06/L-068 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Ju njoftoj se Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e përbashkët me kryetarët e grupeve parlamentare, të mbajtur më 22 qershor 2018, e ka shqyrtuar kërkesën e kryeministrit të Republikës së Kosovës, zotit Ramush Haradinaj, për seancën e jashtëzakonshme për shqyrtimin e Projektligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit me procedurë të përshpejtuar shmangie nga afatet procedurale të paraparë me Rregulloren e Kuvendit.

Kryesia e Kuvendit dhe kryetarët e grupeve parlamentare njëzëri u pajtuan që shqyrtimi i projektligjit të bëhet me procedurë të përshpejtuar shmangie nga afatet procedurale të parapara me Rregulloren e Kuvendit si dhe u vendos që seanca e jashtëzakonshme e Kuvendit të mbahet më 28 qershor 2018, në orën 10:00, me rend ditës: Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Ndërsa shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit të bëhet në një seancë tjetër, dikur pasdite, kur të krijohen mundësitë.

Komisioni Funkcional për Legjislacion, në mbledhjen e mbajtur më 26 qershor 2018, nuk e ka radhitur për shqyrtim në parim projektligjin.

Andaj, propozoj që komisionet të takohen, Komisioni Funkcional për Legjislacion nuk e ka shqyrtuar. Tani propozoj që të jepet pauzë një orë që të ngarkohet Komisioni Funkcional për Legjislacion për shqyrtimin e projektligjit në parim dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime dhe propozimin për shqyrtimin e projektligjit në procedurë të përshpejtuar shmangie nga afatet procedurale të parapara me Rregulloren e Kuvendit.

Tani koha është e deklarimeve të grupeve parlamentare sa u përket çështjeve, për të cilat kemi rënë dakord që të jenë në rend të ditës.

Kryetarja e Komisionit për Legjislacion, zonja Haxhiu, e ka kërkuar fjalën. Zonja Haxhiu, e keni fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, zoti kryesues!

Këtë të hënë ne si komision jemi ngarkuar, por po ashtu kemi marrë një letër nga kryeministri që Projektligji për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të trajtohet dhe të shqyrtohet në procedura të përshpejtuara.

Të paktën letra është sa i përket shqyrtimit të parë dhe jo ndonjë afat tjetër për shqyrtimin e dytë, po megjithatë të martën e kemi pasur mbledhjen e rregullt të komisionit.

Si kryetare e Komisionit për Legjislacion natyrisht kam qenë e detyruar që ta njoftoj komisionin lidhur me kërkesën për shqyrtim të përshpejtuar të këtij projektligji.

Kemi pasur diskutime tepër shumë në komision të martën dhe kemi pasur po ashtu një propozim nga anëtari i komisionit nga radhët e PDK-së që ky projektligj të radhitet në rendin e rregullt të Komisionit për Legjislacion që kishim të martën. Mirëpo, pas diskutimeve ne e kemi vlerësuar domethënë komisioni nuk ka pranuar që ta trajtojë me procedura të përshpejtuara, për faktin se sipas diskutimeve, përfshirë edhe qëndrimin tim, natyrisht këtu edhe anëtarët e tjerë mund ta thonë qëndrimin e tyre, është thënë që ky është projektligj tepër i rëndësishëm.

Kemi para vetes një projektligj që ka më shumë se 100 nene, diku 139, në fakt, faqe, e nene ka 70 e sa. Mirëpo, pavarësisht kësaj, është jashtëzakonisht i rëndësishëm dhe nuk ka të bëjë vetëm me një ndryshim që ka të bëjë me mandatin e EULEX-it, përfundimin e mandatit të EULEX-it, sepse besoj askush nuk është kundër, as nga subjektet e tjera, e lëre më Vetëvendosja që në vazhdimësi ka kërkuar që EULEX-si të largohet. Mirëpo, Qeveria ka ditur kohë më parë që do të përfundojë mandati i EULEX-it dhe pse nuk e ka proceduar më përpara Ministria e Drejtësisë në Komisionin për Legjislacion, për shkak se gjithmonë sa herë po flitet për projektligje të tilla, po na kërkohet me procedura të përshpejtuara.

Andaj, edhe e kemi kundërshtuar pa u lëshuar në përmbajtje të projektligjit, për shkak se përmbajtjen pastaj kur radhitet si temë e diskutimit do ta shqyrtojmë. Por besoj që këtu komisioni nuk ka punë më, sepse nuk ka pranuar që ta trajtojë këtë projektligj në procedura të përshpejtuara.

Pra ky është qëndrimi i Komisionit për Legjislacion. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar ministri, i cili është edhe sponsorizues i ligjit. Zoti Tahiri, e ke fjalën!

MINISTRI ABELARD TAHIRI: Para se ta prezantoj projektligjin, në qoftë se do të vendosim në këtë seancë, ju njoftoj që e para plotësimi-ndryshimi i këtij projektligji ka filluar shumë kohë më parë. Mirëpo pa ndodhur këmbimi i letrave mes presidentit të Republikës së Kosovës dhe Përfaqësueses së Lartë të Bashkimit Evropian, ne nuk kemi mundur formalisht ta procedojmë një projektligj të tillë.

Prandaj, edhe debatet rreth përfundimit të mandatit të EULEX-it nuk është se kanë qenë të vogla, realisht për tetë muaj, sepse ka pasur edhe kërkesa të ndryshme ndoshta që gjyqtarë do të vazhdojnë edhe për një kohë në kuadër të Dhomës së Posaçme, që të vazhdojnë pra gjyqtarët e EULEX-it dhe ka qenë vendosmëri jona që gjyqtarët dhe prokurorët e EULEX-it të përfundojnë mandatin më 14 qershor të këtij viti.

Në qoftë se do ta vendosim, do ta prezantoj, pra nuk është se jemi vonë me kohë.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka filluar promovimin e gjyqtarëve, të cilët do të jenë pjesë e Dhomës së Posaçme, mirëpo në momentin që do të rregullohet baza ligjore, ata mund të bëhen pjesë. Procesi i rekrutimit ka filluar, sepse mund të ndodhë një gjë e tillë, mirëpo nuk mund të finalizohet pa u plotësuar, pa u ndryshuar ky ligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Vetëm të sqarohet për opinionin, sepse nuk po flasim për plotësim-ndryshim të ligjit, po flasim për një projektligj komplet të ri dhe që nuk flitet vetëm për përfundimin e mandatit të EULEX-it, flitet edhe për çështje të tjera që për bindjen time dhe bazuar në analizën tonë si grup parlamentar janë shumë arbitrare, të dëmshme, në disfavor të palëve që në rastin e shumtë janë punëtorët, aksionarët.

Prandaj, edhe nuk kemi të bëjmë vetëm me një ndryshim, sepse sikur të bënim, natyrisht që do të bazoheshim vetëm në atë ndryshim, por kemi të bëjmë me një projektligj komplet të ri, me shumë nene dhe secila prej tyre është e rëndësishme. Prandaj, edhe nuk mund ta trajtojmë kësisoj shpejt e shpejt. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti kryeministri Haradinaj e ka kërkuar fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Mirëmëngjesi, të nderuar deputetë,
I nderuar kryesues,
Kabinet qeveritar,

Kolegë,

E vërtetë që ligji ka shumë materie, është materie shumë e ndjeshme, është substancë.

Këtë ligj s'kemi mundur ta kalojmë në Qeveri deri tani në qershor, më 12 qershor dhe menjëherë në afatet kohore, ndryshe thënë, të zëmë hapin e të mos krijojmë vakum ligjor e institucional.

Pra, është në interesin tonë që të rimarrim këtë proces në pronësi të Kosovës, në pronësi ligjore, po e them, njëkohësisht ligji edhe në etapat e ardhshme, kurdo që Kosova e vlerëson, mund të jetë objekt i trajtimit, i amendamentimit ose i proceseve të tjera.

Po në emër të një kualiteti ndoshta shumë më të madh, e vonesat duhet t'i kem parasysh se krijojmë precedent, ju kisha lutur, meqë jemi këtu dhe e di se është i ndryshëm dhe kërkoj falje që Parlamenti po ashtu të përshejtojë procesin e zgjedhjes së gjykatësve të Gjykatës Kushtetuese. Edhe kjo temë ka peshë, ju e dini plotësisht tema të rëndësishme në të ardhmen lidhen edhe me gjykatën, edhe do të ishte me interes për disa tema të kësaj natyre ta kemi mirëkuptimin e të gjithëve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Meqenëse jemi në proces të negocimit, i jep fjalën edhe një herë zotit Tahiri që të vazhdojë sqarimin e ligjit.

MINISTRI ABELARD TAHIRI: E nderuar kryetare e komisionit,

Ligji për kreditorët dhe punëtorët i rregullon Ligji për AKP-në, jo ligji për të cilën po flasim.

Pra, ajo çka është e rëndësishme, ne sot po bëjmë riorganizimin e Dhomës së Posaçme dhe po zëvendësojmë gjyqtarët ndërkombëtarë me gjyqtarë vendorë, kjo është esenca e këtij projektligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë po vazhdojmë me shefat e grupeve parlamentare. Po fillojmë nga LDK-ja, zoti Hoti e ka fjalën.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues!

I nderuar kryeministër,

Anëtarë të Qeverisë,

Kolegë deputetë,

Në mbledhjen e Kryesisë që e kemi mbajtur ne jemi dakorduar që sot seanca e jashtëzakonshme të organizohet me kërkesë të kryeministrit, duke qenë se mandati i EULEX-it ka mbaruar më 14 qershor dhe Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, disa gjyqtarë që janë aty duhet të zëvendësohen me gjyqtarë vendorë dhe ne jemi pajtuar me këtë.

Por tash neve na ka ardhur një projektligj komplet i ri, me 130-140 faqe, me 70 apo 80 nene që komplet ndryshon në substancë, në mënyrë se si ka funksionuar kjo Dhomë.

Në parim ky ligj është shumë i rëndësishëm, në parim kurdo që vjen në procedura të rregullta në lexim të parë, ne do ta mbështesim dhe do të japim sugjerimet, komentet, amendamentet tona gjatë dy leximeve.

Po ne jemi dakorduar në Kryesi të Kuvendit që sot të kemi seancë të jashtëzakonshme me një nen ose dy nene, si amendamente të ligjit ekzistues, me të cilin ne i zëvendësojmë gjyqtarët e EULEX-it në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, vetëm kaq.

Po ju keni dorëzuar një ligj krejt të ri që ne kemi disa vërejtje bukur të mëdha, dhe si të tillë ne nuk mund ta përkrahim këtë shmangie të procedurave për të shqyrtuar një ligj me 130-140 faqe, me 70 nene të ndryshme, që kanë nevojë për shqyrtim gjerësisht me të gjithë aktorët që janë të involvuar me këtë proces.

Për shembull, një nga vërejtjet tona themelore është kalimi i kompetencave te një gjyqtar i vetëm prej panelit të gjyqtarëve, që në fundament është gabim. Ka një arsye pse në Dhomën e Posaçme është themeluar paneli i gjyqtarëve për të vendosur për miliona euro që u shpërndahen punëtorëve ose për çështje kontestuese të ndryshme që shqyrtohen këtu dhe plot vërejtje të tjera.

Pra, ne në parim do ta mbështesim këtë projektligj në procedura të rregullta, ne jemi kundër që të shmangen procedurat për të shqyrtuar një ligj kaq të rëndësishëm.

Nëse ju e sillni një nen, dy nene si amendamente të ligjit ekzistues për të zëvendësuar gjyqtarët e EULEX-it në këtë Dhomë, ne jemi dakord, po kështu si e keni prezantuar, ne nuk mund ta mbështesim që të shmangim procedurat për një çështje kaq të rëndësishme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Memli Krasniqi, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar kryesues,

I nderuar kryeministër,

Ministra,

Kolegë deputetë,

Të gjithë sa folën deri më tash, besoj që edhe ata që do të flasin pas meje po pajtohemi që është një projektligj shumë i rëndësishëm.

Edhe fakti që është një projektligj shumë i rëndësishëm nuk do të thotë që një projektligj i tillë nuk mund të kalojë përmes procedurës së përshpejtuar, sepse shumë projektligje të tilla ne i kemi miratuar pikërisht përmes procedurës së përshpejtuar.

Si Parti Demokratike, si Grup Parlamentar ne e kemi mbështetur këtë qasje edhe në mbledhjen e Kryesisë, kur është vendosur që të mbahet seanca e jashtëzakonshme sipas kërkesës së kryeministrit, por edhe në diskutimet e deritashme.

Këtu i kemi dy situata, nëse ne sot vendosim që të shkojmë me procedurë të përshpejtuar, ne mund ta ndryshojmë legjislacionin aktual menjëherë dhe ta funksionalizojmë Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, t'i krijojmë mundësi Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe instancave të tjera që ta përfundojnë punën dhe obligimet e përgjegjësitë që i kanë, në mënyrë që të funksionalizohet ky trup i rëndësishëm dhe që të mos ketë bllokime në procesin që ndërlidhet me privatizimin.

Nëse ne vendosim, ashtu siç po kërkon opozita, që të shkojmë me procedurë të rregullt, ju e dini që atëherë nevojiten së paku dy muaj, orientimisht sipas Rregullores së Punës edhe ne do ta përfundojmë sesionin kah fundi i korrikut dhe atëherë po flasim që këtë ligj ta ndryshojmë diku në muajin tetor. Esencialisht kërkesa e opozitës i bie që të mos funksionalizohet Dhoma e Posaçme para fundit të vitit 2018, që rrjedhimisht nënkupton që asnjë proces që ndërlidhet me privatizimin dhe që është objekt i trajtimit në Dhomën e Posaçme të mos mund të trajtohet para fundit të vitit 2018 ose ndoshta edhe fillimit të vitit 2019.

Nuk besoj që ka çfarëdo relevance të këtyre diskutimeve ose pikave, të cilat më shumë u parafrazuan nëse nuk u përmendën, por u thanë që janë, të cilat janë më të rëndësishme se sa zhbllokimi i këtij procesi, i cili edhe ashtu të gjitha partitë politike pajtohemi ka probleme, ka defekte dhe ka vonesa.

Andaj, nëse me të vërtetë e paskan lexuar projektligjin, kanë vërejtjet e veta, unë nuk e shoh të pamundshme që këto vërejte të adresohen edhe përmes procedurës së përshpejtuar. Mund të bëhen amendamentet edhe në mes këtyre dy leximeve. Nëse secili grup parlamentar thotë që kanë ekspertë, e kanë trajtuar si grup, e njohin lëndën, atëherë le t'i angazhojnë këta ekspertë që i kanë brenda grupit, le të vinë me propozime, besoj që për propozime të rëndësishme do të gjendet edhe qëndrimi i përbashkët i të gjitha grupeve parlamentare, qoftë në komision, qoftë në seancë dhe pastaj mund të procedojmë.

Por unë besoj fuqishëm që përfundimi i mandatit të EULEX-it është pika më e rëndësishme e këtij ligji dhe ne duhet ta mundësojmë zëvendësimin e gjykatësve të EULEX-it me gjykatës vendorë dhe për ta bërë këtë mënyrë sa më të shpejtë. Neve na duhet që të shkojmë përmes

procedurës së përshpejtuar, siç kërkon edhe shkresa e kryeministrit, po e them, për hir të korrektësisë.

Atë ditë kur kemi vendosur në Kryesi, ne kemi qenë të vetëdijshtëm që po flasim për procedurë të përshpejtuar, për dy seanca brenda ditës. Nëse nuk duam t' i bëjmë dy seanca brenda ditës, ne sot mund të pajtohemi se seanca e parë kjo që jemi ta trajtojmë sot projektligjin në lexim të parë dhe projektligji në leximin e dytë le të vijë nesër, nëse jo sot, le të vijë të hënën, mund ta bëjmë edhe të martën, po nëse shkojmë në procedurë të rregullt, ne po flasim për fundin e vitit 2018, pra për një bllokim të mëtutjeshëm për së paku gjashtë muaj, gjë që nuk absolutisht nuk e shoh të arsyeshme, përkundrazi e shoh edhe të rrezikshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për ta sqaruar pak këtë çështje, ligji i plotëson kushtet për seancë të rregullt më 6 korrik të hyjë, domethënë javën e ardhshme, ju e vendosni. Po nëse ne përgatitemi, mund ta bëjmë një javë mbrapa 6 korrikut ose një ditë ose dy ditë, nuk domethënë që domosdoshmërisht të shtyhet dy muaj. Mundësitë i kemi ta shqyrtojmë ligjin edhe sot, po nëse nuk bëhet, atëherë në seancë të rregullt duhet të vijë më 6 korrik.

Zoti Haradinaj, kryeministri, e ka kërkuar fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Ndoshta proceduralisht çfarë dinamike dhe sa kohë u nevojitet ekspertëve të partive politike për të dhënë kontributin për ligj, atë mund ta diskutoni si deputetë dhe të bini dakord.

Por, ju kisha lutur, mos ikni prej dakordimit të Kryesisë që të kalojë në këtë formë, pra në këto procedura të parapara të seancës të jashtëzakonshme, kjo është edhe një tregues, për fat të mirë ose për çfarëdo fati, ta themi, është edhe një tregues i seriozitetit të marrëdhënieve tona me BE-në.

Ju siguroj nuk e kam veç të kalojë ligji, po edhe liberalizimin dhe me të gjitha temat e tjera. Ju e dini liberalizimi është rend dhe ligj, ata i kanë tërhequr përgjegjësitë e veta dhe nëse Kosova tregon një neglizhencë në marrje të përgjegjësive, është njëri prej atyre treguesve që mund ta nxjerrë Kosovën në pozicion të kritikueshëm.

Tani vërtet sa i përket përmbajtjes, substancës, edhe ato që i tha profesor Hoti edhe Albulena ose dikush nga ju i keni, ju mund t'i trajtoni ato me pauza kohore që mund të gjenden pikërisht për atë, por nuk do të ishte në rregull nëse nga mundësia që ta marrim këtë përgjegjësi dhe ta kthejmë një porosi që i marrim përgjegjësitë seriozisht, ta përcjellim një porosi tjetër që kishte mundur të jetë jo e mençur për qytetarët tonë në këtë kohë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar Vetëvendosje, zonja Haxhiu e ka kërkuar fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Tash po flas në emër të Grupit Parlamentar, sepse më përpara fola në emër të komisionit.

Së pari, ne kemi marrë gjithë këtë projektligj dhe këtu është edhe një deklaratë financiare, gjegjësisht e përgatitur nga Ministria e Financave, Departamenti për Financa, i cili thekson që ky projektligj ka implikime financiare, të cilat nuk janë të parapara në Ligjin për buxhetin e vitit 2018.

A ma shpjegoni pse po na ngutni, pra? Në qoftë se nuk ka buxhet për ta zbatuar këtë ligj dhe, në anën tjetër, po gjeni buxhet për t'ia rritur pagat vetes, atëherë pse po na vendosni para një situatë të tillë?

Unë këtu e kam projektligjin, Drejtoria e Financave ka thënë që ka implikime buxhetore, madje që s'janë të parapara as në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve.

Tjetra, duke pasur parasysh që ky është një projektligj shumë i rëndësishëm, natyrisht që ndoshta më mirë është që të vonojmë pak deri sa ta trajtojmë, se sa ta kalojmë shkel e shko, sepse kjo shkel e shko do të jetë në kurriz të punëtorëve.

Ta keni parasysh që janë bërë shkelje të mëdha në procesin e privatizimit.

Unë kam kërkuar informacione nga Gjykata Supreme, gjegjësisht Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, sa janë lëndë që aktualisht presin në këtë Dhomë që janë të pazgjdhura? A e dini sa janë? 21 300 lëndë janë të pazgjdhura dhe në qoftë se ne e zgjasim edhe një muaj më shumë, domethënë 5 vjet ka lëndë që janë duke pritur atje.

Pra, kërkesa jonë e vetme është: ne duam kohë për ta trajtuar këtë, nuk po them deri në tetor, sepse tendenca e Memlit ishte që ta banalizojë qëndrimin e opozitës, nuk po themi deri në tetor. Po duke pasur parasysh që me këtë projektligj aktual shkelen të drejtat e punëtorëve, sepse ka procedura që janë në disfavor të punëtorëve, ne kërkojmë që të kemi afatin kohor të arsyeshëm që ta trajtojmë këtë.

Pra, ne si grup parlamentar nuk pranojmë që ta trajtojmë me procedura të përshpejtuara, aq më shumë kur po kërkohet që e njëjta seancë për shqyrtim të dytë të mbahet sot, s'ka asnjë kuptim. Më 6 korrik ngarkohet Komisioni për Legjislacion, e trajton në parim, e sjell në seancë dhe pastaj besoj para pushimit do të mund ta trajtonim sërish. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Edhe një herë ministri Tahiri e ka kërkuar fjalën.

MINISTRI ABELARD TAHIRI: Një sqarim sa u përket implikimeve buxhetore.

Këta gjyqtarë nuk do të vijnë nga jashtë, këta janë pjesë e sistemit tonë, këta vetëm do të promovohen, këta aktualisht marrin paga, janë pjesë e sistemit, veç do të promovohen nga Apeli do të jenë pjesë e Gjykatës Supreme. Pikërisht pra është çështje e Këshillit Gjyqësor që e rregullon, nuk është problem financiar që duhet tash për tash të jetë ndërhyrje nga Ministria e Financave.

Ndërsa me Projektbuxhetin për vitin 2019 normalisht që parashihet të rritet edhe stafi mbështetës, pra pikërisht për këtë Dhomë.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Krasniqi edhe një herë.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit!

Albulena e përmendi banalizimin, banalizim është të flitet për diçka që s'ndërlidhet drejtpërdrejt me temën dhe ju nja pesë herë e përmendët punëtorët, punëtorët, e ne jemi duke folur për një ligj që mund të ketë ndikime anësore në çështjet që ndërlidhen me punëtorët, janë ligjet e tjera që i rregullojnë ato çështje, duke e përfshirë 20%-shin dhe procedurat.

E vërteta është kjo, ka dy mënyra si mund të procedojmë: me procedurë të përshpejtuar dhe me procedurë të rregullt. Procedura e përshpejtuar nuk thashë brenda ditës, përkundrazi, unë isha shumë i qartë, thashë mund të vendosim sot të kalojmë në lexim të parë dhe të merremi vesh për sa ditë të kalojmë pastaj leximin tjetër, derisa të trajtohet projektligji dhe procedura e dytë është qysh e parashihet Rregullorja që ka 2 muaj kohë për ta rregulluar. Tani këta dy muaj kohë, kur e ke parasysh në fund të këtij muaji ose në fund të korrikut, në fakt, përfundon sesi dhe Kuvendi shkon në pushim deri në javën e tretë të shtatorit, tregomëni mua sa muaj i bien. Ose a po pajtoheni me propozimin tim, le të kalojmë sot, jemi në seancë të jashtëzakonshme, këtë s'mund ta shmangim. Nëse s'pajtoheni të shkohet me procedurë për një periudhë shumë të shkurtër, ne mund të pajtohemi si grupe parlamentare dhe si seancë sot që të themi: po e kalojmë sot në parim, seancën e ardhshme e kemi 5 korrik, dhe po e fusim në rend të ditës për 5 korrik pikën e parë të rendit të ditës, leximin e dytë të këtij projektligji.

Nëse s'ju duket mjaftueshëm që keni kohë, se keni punë të tjera, ta bëjmë më 12 korrik, sepse është seanca e radhës, që unë besoj të mbahet pas datës 5 korrik, por mos thoni: "Po shkojmë në procedurë të rregullt, e kryejmë", sepse po kërkon bash për ta lënë për fund vitit, se ndryshe kjo nuk kalon përveç kah fundi i këtij viti, se Kuvendi nuk e shqyrton deri në fund të korrikut dhe pastaj shkon në pushim, kthehet tek fund të shtatorit dhe kjo punë nuk kryhet. Kërkesa dhe propozimi ynë është ta gjejmë mundësinë të kryejmë punë, po thoni "duhet ta trajtojmë". Mirë, sot e kalojmë në lexim të parë, kthejuni ju komisioni, kryeni pjesën e punës tuaj dhe pastaj e keni

një javë, dy javë, sa javë ju duhen për ta lexuar dhe trajtuar këtë ligj? Nuk është Kushtetuta e Kosovës, ligj i rëndësishëm, por Kushtetuta e Republikës së Kosovës nuk është. Nëse e keni lexuar, keni mendime, keni qëndrime, ideologjike, politike, çfarëdo qofshin, urdhëroni, kryeni punën, se ma merr mendja që ka ligje edhe shumë më të rëndësishme që për një javë mund të trajtohen. Por, nëse doni të gjeni zgjidhje, atëherë qe propozimi: e kryejmë me procedurë të përshpejtuar dhe zotohemi që më datën 5 korrik e sjellim në seancën e radhës, ajo është e caktuar. Nëse jo, e sjellim dy, dhjetë ditë më vonë, sot e caktojmë seancën, por mos thoni po shkojmë me një procedurë tjetër, se atëherë e vërteta e fshehur në këtë kërkesë është të lihet për fund vitin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Frashër Krasniqi e ka fjalën, në emër të Grupit Parlamentar të PSD-së.

FRASHËR KRASNIQI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Partia Social Demokrate ka po ashtu problemin e njëjtë me partitë e tjera opozitare në lidhje me procedurën e përshpejtuar, përmes të cilës ka ardhur ky ligj dhe po tenton të vijë ky ligj. Mirëpo, në anën tjetër, ne kemi edhe probleme përmbajtjesore me ligjin, të cilat do të na pamundësojnë ta votojmë nëse ligji mbetet si i tillë, sepse ka shumë probleme ky ligj.

Mendojmë që është shumë jokorrekte edhe nga ana e kryeministrit, edhe nga ana e ministrit dhe kujtdo tjetër nëse i referohet vendimit të marrë në mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit, ngase ka qenë e qartë që në mbledhjen e Kryesisë është marrë një vendim, duke u propozuar thjesht të ndërrohen, thjesht të zëvendësohen gjykatësit e EULEX-it, ndërsa nuk është folur fare, nuk është diskutuar fare se do të vijë një projektligj, i cili ndërron rrënjësisht nga ai çka e kemi pasur deri tash për rregullimin e Gjykatës Supreme. Ne kemi problem, jemi të vetëdijshëm që procesi i privatizimit në Kosovë është një prej proceseve më të dëmshme ekonomike dhe sa i përket krejt shpërdorimit dhe korrupsionit në Republikën e Kosovës. Kemi rreth 80 mijë punëtorë që kanë mbetur pa punë si rezultat i privatizimit, kemi diku 20 mijë lëndë në gjykata që janë duke u trajtuar në lidhje me keqpërdorimet që janë bërë me procesin e privatizimit dhe, si i tillë, është tërësisht e pakuptueshme, madje lë hapësirë për dyshime, sepse po tentohet që kjo gjykatë që e trajton një institucion kaq të rëndësishëm dhe një proces kaq të rëndësishëm, kjo gjykatë të vihet në procedurë të përshpejtuar.

Kemi pasur propozim, ta zëmë, në mbledhje të komisionit prej përfaqësuesit të PDK-së, zotit Çoçaj, që edhe leximi i parë edhe i dytë të kryhen brenda një dite. Pra, ka një nguti të pashpjegueshme për këtë punë dhe, dorën në zemër, pajtohem që është komplet lojë kjo çka po e bën Memli në lidhje me afatet kohore, sepse ka mundur të vijë ky ligj në procedurë të rregullt në

seancën e ardhshme, siç e propozoi edhe kryesuesi. Pse duhet patjetër një procedurë të përshpejtuar aq sa të mos arrihet as në komision të trajtohet mirëfilli kjo temë.

Ky ligj ka shumë probleme, problemet kryesore të këtij ligji janë fakti që reduktohen trupat gjykuese nga një koleg gjykues, në një gjykatës të vetëm, që lë hapësirë shumë më të madhe dhe shumë më të lehtë për keqpërdorime dhe për afera të ndryshme. Dhe, në anën tjetër, e kemi po ashtu kolegjin ose apelimin brenda Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda të njëjtit institucion. Pra, i njëjti institucion, i cili i trajton lëndët, tek i njëjti institucion dhe apelohe ato vendime që janë marrë. Pra, ka një problem bukur të madh dhe ka një rregullim ligjor, i cili lë shumë hapësirë për keqpërdorime, nëse e kemi parasysh që me këtë ligj rregullohet që kryetari i Gjykatës Supreme do të jetë edhe kryetari i Dhomës Posaçme. I njëjti kryetar do t'i caktojë trupat gjykuese për gjykimin fillestar, i njëjti kryetar do ta caktojë Kolegjin e Apelit. Kjo është një konflikt problematik dhe ka dhe probleme të tjera, të mos hyj tash në përmbajtje, të cilat përveç që e bëjnë dyshuese faktin që po tentohet të kontrabandohet në procedurë të përshpejtuar, e bëjnë edhe të papranueshme për Partinë Social Demokrate dhe si ligj në tërësi, nëse nuk ka ndryshim.

Dhe, prapë nuk e kuptoj pse nuk është bërë propozimi në mbledhje të Kryesisë ashtu siç na ka ardhur pas mbledhjes së Kryesisë. Pse keni tentuar të bëni një propozim krejt tjetër dhe ta kontrabandoni gjoja si zëvendësim i EULEX-it, ndërkohë na keni sjellë diçka krejt tjetër. Faleminderit!

KRYESUESI: Në rregull! Zoti Haradinaj, kryeministri, e ka kërkuar fjalën. Për replikë është lajmëruar zoti Çoçaj.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Shikoni, po më duket që Frashëri dhe kolegët gati po e shohin prej dy perspektivave këtë punë. Nga perspektiva e Qeverisë nuk kemi bërë ndonjë tendencë tjetër ose nuk kemi shkuar me ndonjë tendencë, përpos në procedurat e parapara ta dërgojmë ligjin. Pra, ligji për të cilin ne sot po diskutojmë, ia kemi dërguar Parlamentit, pra ligji është material juaj tani, dhe po për këtë ligj e kemi kërkuar seancën e jashtëzakonshme, procedurën e këtillë çfarë e kemi paraparë. Pra, ju siguroj që nuk ka këtu dy situata, është një, nëse në diskutim në Kryesi nuk është hyrë në përmbajtje, por ne e kemi dërguar për këtë ligj kërkesën, nuk është një ligj tjetër, edhe diskutimet që i bëni, shikoni, ju e dini, kush ka qenë deputetë, ne i kemi përkthyer ato rregulloret e UNMIK-ut dikur, ajo Rregullore i ka pasur 70 nene, por dy apo tri prej tyre kanë pasur peshë ndoshta. Ne i kemi kaluar atëherë prej legjislacionit të OKB-së në tonat.

Ju lus, ta kemi parasysh faktin se e kemi një ligj këtu, nuk ka kush që i interesojnë temat e Kosovës, edhe neve besoj që na intereson edhe koha, që të mos mbetet gjendja në vakum. Nëse ju duhet një javë nga seanca e sotme për punë në substancë të ligjit, se nuk kemi ardhur ta

mbrojmë një element të caktuar të substancës së ligjit, të themi vetëm kështu, e jo ashtu. Ne kemi kërkuar mirëkuptimin tuaj, të partive politike, grupeve politike, në interesin e të gjithë neve që të mos krijojmë vakum. Nëse ju duhet një javë ose dhjetë ditë, nëse është nevoja mund të caktojmë një etapë tjetër, për shembull, më 10 korrik mund të kthehemi këtu për lexim të dytë dhe të shfrytëzohet koha në mes. Po ju siguroj që Qeveria nuk ka ardhur të mbrojë një nen, cilindo qoftë, që mund të jetë i diskutueshëm, por ka ardhur të kërkojë ndihmën tuaj të mos lejojmë vakumin dhe të mos krijojmë porosi të gabuar për të gjithë ne.

Pra, të mos e shprehim ne kapacitetin tonë si Parlament, si institucione që mund t'i absorbojmë këto përgjegjësi në kohën që kanë ndodhur. Pastaj, për substancën, edhe ministri do të jetë konkret të japë shpjegimet e veta nen për nen, nëse është nevoja, edhe ju e keni mundësinë, janë ekspertët e partive që mund të kontribuojnë. Po ju kisha lutur mos e humbni mundësinë që në lexim të parë, për shembull, ta trajtoni sot, ta trajtojmë sot, do të thotë Parlamenti, pastaj nëse nevojitet një javë ditë ose nuk po di sa, po vendosim bashkë pa problem. Është keq nëse nuk e bëjmë në një afat të caktuar kohor dhe në këtë rast keq jo për një palë, nuk është veç një palë në pyetje, jemi të gjithë, dalim të pazot. Kemi pritur për 10 vjet, EULEX-it i kemi thënë shkoni, shkoni, dikush ndoshta edhe rrini, po tani ka ndodhur de facto, e ne s'jemi të zot të kalojmë ligjërisht një situatë vendore, domethënë nuk ka logjikë nëse s'e bëjmë kështu. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nezir, ti ke të drejtë në replikë. Zoti Çoçaj e ka fjalën.

NEZIR ÇOÇAJ: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

I nderuar kryeministër,

Ministra,

Kolegë deputetë,

Sa për sqarim, unë si pjesë, si anëtar i Komisionit për Ligjet kam propozuar që të futet në rend të ditës, duke ditur rëndësinë e këtij ligji dhe rrethanat në çfarë jemi. Ne të gjithë e dimë mandatin deri kur ka pasur EULEX dhe me këtë qëllim kam propozuar, por nuk kam pasur as mundësi, as forcë që as ne si komision ta detyrojmë seancën të bëjë leximin e parë apo leximin e dytë brenda një seance apo brenda një dite. Kjo do të vendosej në seancë, seanca vendos çdoherë. Po ajo që mua më ka shqetësuar dhe më brengos fakti që ne si pjesë e këtij komisioni, gjegjësisht kryesuesi a kryetarja e këtij komisioni më shumë po merren me çështje politike se sa me çështje procedurale dhe çështje të tjera që ngarkohet në bazë të Rregullores së Kuvendit vetë komisioni ynë.

Kjo ka qenë edhe shqetësimi ynë si anëtarë të komisionit. Andaj, nuk ka mundësi që ne apo dikush të kërkojë një gjë të tillë të trajtohet përbrenda një seance apo sido që të jetë. Unë po ashtu kam propozuar, ka pasur diskutime që ministri të ftohet, të japë sqarime. Kanë thënë po, do të jemi të pajtimit që të mërkurën të thirret ministri i Drejtësisë, pastaj është shqyrtuar mundësia që ministri s'është, ndoshta ministri s'vjen. Me këto farë mendimesh dhe idesh nuk jemi pajtuar,

është fare e qartë që komisioni nuk ka dashur, po shihet që deputetët që janë pjesë e këtij komisioni, të opozitës, nuk kanë dashur ta trajtojnë dhe nuk duan ta trajtojnë as në seancë sot. Unë mendoj se për shkak të peshës dhe rëndësisë ta trajtojmë në seancë, pasi seanca është e thirrur nga kryeministri si seancë e jashtëzakonshme dhe mendoj se duhet ta trajtojmë sot.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hoti, a deshe edhe ti diçka? Zoti Hoti e ka fjalën.

AVDULLAH HOTI: Unë mendoj që një pjesë e diskutimit vërehet është e panevojshme, në veçanti nga zoti Krasniqi. Në fjalën time kur e thashë qëndrimin e grupit parlamentar, e bëmë të qartë se ne jemi që sot menjëherë brenda ditës t'i mbajmë dy seanca për të ndryshuar ligjin ekzistues me një amendament ose dy për të zëvendësuar gjyqtarët e EULEX-it në këtë Dhomë.

Pra, ne po japim rrugën se si mund të zhbllokohet situata, atë që po e kërkon kryeministri dhe t'u japim deputetëve, edhe aktorëve të tjerë mjaft kohë që të shqyrtojnë ligjin në detaje në procedura të rregullta. Pra, dorëzoni sot një amendament, dy amendamente dhe menjëherë brenda ditës i mbajmë dy seanca, e zhbllokojmë këtë Dhomë, këtë institucion, dhe shkojmë më tutje. Por, çfarëdo diskutimi tash që po mundohet të devijohet çështja, mendoj që është i panevojshëm dhe nuk i kontribuon zgjidhjes së situatës.

KRYESUESI: Kundër-replikë ka zoti Krasniqi.

MEMLI KRASNIQI: Zoti kryesues, unë sa herë të ma përmendin emrin, do ta përsëris propozimin. E kalojmë sot në parim, kur po do opozita ta kalojmë herën e dytë, a po doni pas një jave? A po doni pas dy jave? A mbas sa jave po doni? Veç kallëzoni drejt, mos thoni "këqyrim" se "këqyrim" na mbetët në nëntor. Unë prapë po them sot mund ta fusim në procedurë me marrëveshje, sot e kalojmë në parim, sepse në parim kalon kështu-ashtu, kurdo që të vijë, e pastaj urdhëroni me ekspertizën tuaj, me amendamentet që do t'i sillni, por tregoni kur, a doni ta kryejmë për datën 5, sepse në mbledhje të Kryesisë jemi marrë vesh që në seancën e datës 5 të përfshihen të gjitha projektligjet, të cilat i kalojnë procedurat dhe përmbushin kushtin deri atë ditë. Nëse s'doni më 5 korrik, e lëmë më 12 korrik, nëse s'doni më 12, caktojeni ditën. Po hajt ta kryejmë gjatë muajit korrik, ta kryejmë që të mund të hyjë në fuqi para se muajit korrik, këtë po e bëjmë. Nëse doni të thoni që s'dalin 10 ditë të trajtohet një ligj, atëherë më mirë thoni s'duan ta kryejmë këtë ligj.

S'ka ligj në Kosovë që nëse do një komision, s'mund ta trajtojë edhe për 3-4 ditë, edhe me 100, 200 faqe dhe me 200 nene. A po e di, edhe Kodin Penal, nëse doni, e lëre më këtë ligj, i cili ju po thoni ka shumë ndryshime, e vërteta është që s'ka aq shumë ndryshime. Ka ndryshime pa dyshim, se ka ndryshuar konteksti, ka shkuar EULEX-i tash, s'ka më EULEX, tash janë institucionet e Kosovës, normalisht që ka ndryshim, sepse ka ndryshuar diçka. Por, veç

propozojeni datën, ne po ju mbështesim, thoni po duam me këtë datë në korrik ta kryejmë për lexim të dytë, sot e kalojmë në lexim të parë, kurrëgjë tjetër s'po ju them. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër, edhe një herë dhe ju kisha lutur që t'i leni tash kryetarët...

MINISTRI ABELARD TAHIRI: Kemi të bëjmë me riorganizimin e një Dhome të Posaçme, nuk kemi të bëjmë me një ligj që do aq shumë angazhim, pra qoftë nga Komisioni për Legjislacion, qoftë nga ju deputetë. Zoti Hoti, me gjithë respektin për ju, mirëpo shumica e këtyre amendamenteve që janë propozuar lidhen pikërisht me punën e gjyqtarëve të deritanishëm me përfundimin e mandatit të gjyqtarëve të EULEX-it. Nuk mundemi me një nen ta amendamentojmë ligjin në përfundimin e mandatit të EULEX-it. Pra, edhe këto 21 mijë e 300 lëndë që janë mbledhur për gjithë këto vite, janë si rezultat i mosefikasitetit pikërisht pra të kësaj Dhome, të organizimit të paneleve, edhe në të kaluarën, edhe me ligjin e kaluar ka qenë e paqartë, se ka mundur të organizohet një gjyqtar, një panel në shkallën e parë, mirëpo s'është bërë asnjëherë.

Unë prapë jam për të biseduar edhe këtë çështje, sepse në fund të fundit, është çështje e interesit nacional se qysh ne vendosim ta trajtojmë më tutje këtë çështje. Por, ajo çka është e rëndësishme unë kisha propozuar sot që ta kalojmë në lexim të parë, t'i japim 2-3 javë komisionit shtesë që vërtet brenda muajit korrik ta përmbyllim këtë çështje. Pra, besomëni që ne do t'i zhblllokojmë qindra-miliona euro që mbahen në BQK, e të cilat nuk shfrytëzohen as nga Qeveria e Kosovës, as nga punëtorët, as nga kreditorët, domethënë nga askush. Është një çështje, mos e lidhni me mandatin e AKP-së, ajo është çështje komplet tjetër, po e lidhim me kontestimet që janë brenda kësaj Dhome dhe mosfunksionalitetin e saj për të gjitha këto vite. Ndoshta unë s'po dyshoj që mund të ketë edhe ide që ne ndoshta s'i kemi pasur nga deputetët e Komisionit për Legjislacion apo tjerët, të cilët vërtet mund të na ndihmojnë në riorganizimin e kësaj Dhome.

Mirëpo, ka pasur edhe ide të ndryshme që kjo Dhomë të shuhet krejt dhe të kalojë nëpër gjykata themelore. Ne kemi menduar që mund të komplikohet çështja edhe më shumë, prandaj propozimi im, besoj edhe i kryeministrit sot, ta trajtojmë në shqyrtim të parë, ta miratojmë, t'i japim kohë dy ose tri javë Komisionit për Legjislacion, sepse kemi të bëjmë vetëm me riorganizimin dhe me përfundimin e mandatit të EULEX-it, me asgjë tjetër. Ju siguroj nuk ka asnjë çështje tjetër që trajton ky projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hoti, e deshe fjalën, se s'e pashë që u paraqite, a e shtype gabim, a deshe të replikosh? Në rregull! Atëherë, zoti Demaliaj e ka fjalën në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së.

SHKUMBIN DEMALIAJ: I nderuar nënkryetar i Kuvendit!

Kryeministër, ministra,

Kolegë të nderuar deputetë,

Jemi duke biseduar diçka që proceduralisht është gjithëka në rregull, se sikur të kishte qenë jo në rregull proceduralisht, ndoshta kishim menduar edhe për ta orientuar ndryshe. Qeveria ia ka drejtuar Kuvendit këtë projektligj, është në dorën e Kuvendit a do t'i shmanget Rregullores për ta trajtuar në procedim të shpejtë a jo? Lidhur me historikun qysh kemi ardhur deri këtu, fatkeqësisht e them se me arbitraritet ka luajtur me këtë projektligj kryetarja e komisionit, zonja Albulena Haxhiu. Nuk e ka futur në rend të ditës hiç, Kryesia e Kuvendit ka vendosur të vijë në seancë, anëtarët e komisionit i ka nxjerrë para aktit të kryer duke i shfrytëzuar votat e deputetëve në komision për shkak se nuk ishte një deputet prezent.

Ne kemi votuar, kemi votuar pesë kundër, pesë për, edhe nuk ka kaluar për të hyrë në rend dite, me atë arbitraritet, duke e shfrytëzuar të drejtën e të qenit kryetare e komisionit dhe duke shantazhuar para opinionit publik lidhur me procedimin, ka futur pika të jashtëligjshme në rendin e ditës, edhe antikushtetuese, Shqyrtimin e dekretit të Presidentit. Ne ta shqyrtojmë aty, e nuk e fut ligjin që ka kaluar në Kryesi për t'u proceduar në Kuvend. Lidhur me këtë çështje, të gjitha ato propozime që u dhanë deri tash, janë dy forma procedurale: është forma që të shkojmë në procedurë të rregullt, ose të votojmë shmangien dhe ta votojmë në parim dhe të procedojmë 1-2 javë, ashtu siç po thotë edhe zoti Krasniqi, por po e shoh që është në pajtim edhe Grupi Parlamentar i LDK-së.

Lidhur me arsyetimin që po e jep zoti Hoti, kemi menduar për një ndryshim. Unë besoj se edhe në Kryesi ka ardhur projektligji, e kanë parë çfarë ndryshimi. Nomenklatura e normativit ndryshon, nuk është e rregulluar vetëm hajt po i shkarkojmë gjyqtarët e EULEX-it dhe ta lëmë vetëm një nen aty. Ajo ndryshon në vazhdimësi. Në këtë rast propozoj që të vazhdojmë me procedim, Grupi Parlamentar i Aleancës është për, edhe ta kalojmë në parim e t'i japim mundësi komisionit me amendamentim ndërmjet dy leximeve që të japë rezultatet e veta secili prej deputetëve. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Sherifi e ka fjalën, në emër të Grupit Parlamentar Nisma.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, zoti kryesues!

Ne, siç u tha deri më tash, në Kryesi kur është trajtuar ky projektligj apo kur është trajtuar kërkesa e kryeministrit për seancë të jashtëzakonshme, të gjithë kemi qenë dakord që të thirret kjo seancë për të debatuar këtë ligj. Është e vërtetë që në atë kohë kur kemi rënë dakord, ne nuk e kemi pasur në tërësi projektligjin para vetes që të shohim se cilat janë ndryshimet që janë bërë në ligj, që të mund, së paku kolegët nga opozita, të thonë atë që kanë për të thënë që në mbledhjen e Kryesisë. Është e drejtë e tyre që të gjitha vërejtjet, të cilat i kanë përmbajtjesore, t'i ngrenë në

momentin kur e kanë projektligjin, por unë nuk shoh që jemi në fazën e ngritjeve të problemeve apo çështjeve përmbajtjesore sa i përket projektligjit.

Jemi ende në fazën procedurale dhe sa i përket aspektit përmbajtjesor, mendoj që 2-3 javë, bile më kujtohet kolegët nga Vetëvendosja, zoti Kurteshi ka thënë 3-4 javë po qe se do t'i kishim në dispozicion do të ishim dakord që të procedojmë me ligjin, që ta bëjmë në lexim të parë, por dy lexime t'i bëjmë brenda disa ditëve, sepse nuk do të kishim kohë pastaj për ta shqyrtuar. Unë e mbështes tani këtë ide që sot të mbahet mbledhja e komisionit, ta kalojmë formalisht që ta sjellë në seancë, ta nxjerrim në lexim të parë dhe të biem të gjithë dakord, të mos e shndërojmë këtë betejë çështje numrash, kush i ka numrat, e shtyn përpara, kush s'e ka, s'e shtyn përpara, por të merremi vesh që pas 2-3 javësh të thërrasim një seancë, në të cilën do ta bënim leximin e dytë dhe brenda kësaj periudhe do të kishim kohë të gjitha grupet parlamentare, të gjithë deputetët të japin vërejtjet e tyre. Unë vetëm po e them një çështje, për të cilën u tha shumë, u fol shumë: punëtorëve vetëm mund t'u përshpejtohet zgjidhja e problemeve, sepse deri më tani janë shkelur shumë, ka punëtorë që 5 vjet u është shitur ndërmarrja dhe asgjë s'kanë marrë. Ka punëtorë, të cilët kanë vdekur duke i pritur këto para dhe nuk kanë arritur t'i marrin. Pra, ejani që së bashku, në funksion të mbrojtjes të drejtave të atyre punëtorëve t'i përmirësojmë ato nene, atë pjesë të ligjit, përmes së cilëve mund të konsiderojmë se nuk do të realizojnë punëtorët të drejtat e tyre të plota.

Ndërsa, kjo çështja se vetëm një gjykatës do të ketë të drejtë të shqyrtojë çështjen në lexim të parë, më besoni që nëse e bëjmë dhe e që në shkallë të parë me 3 apo 4 gjykatës, do të duhen edhe pesë vjet të tjera që së paku në shkallë të parë të përfundojnë lëndët. Të gjitha lëndët, për të cilat palët nuk do të pajtohen, janë kolegjet, janë shkalla e dytë, ku aty më nuk vendos dot një gjykatës, janë tre e më shumë gjykatës, në ligj e ke, të sanksionuar, vepron përmes dy kolegjeve. Pra, kur ta themi një çështje atje, le ta themi të vërtetën e plotë. Shkalla e parë ka të bëjë me një gjykatës, për faktin se kërkohet një efikasitet më i madh dhe nëse në atë rast nuk ka kontestime, ku është problemi, pse të mos vendosë një gjykatës? Në momentin kur ka kontestime, pastaj vijmë në shprehje tre gjykatës, për të parë se a ka pasur korrupsion, a ka pasur keqpërdorime, a ka pasur vendime të padrejta dhe kështu me radhë.

Pra, le të ndalemi sot në nivelin procedural, le ta bëjmë një pajtueshmëri që ta kalojmë në lexim të parë dhe të hyjmë pastaj të gjithë së bashku, deputetë, grupe parlamentare, dhe të shohim ku mund ta përmirësojmë, sepse edhe unë shoh dhe besoj që do të kemi vërejtjet tona dhe sugjerimet tona, se si ky ligj brenda tre deri në katër javë, para se të shkojmë në pushim ta përmirësojmë edhe ta miratojmë ligjin, në mënyrë që punëtorëve pastaj të fillojnë të ju realizohen të drejtat e tyre. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani kemi sipas rregullave përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Kujtimi është anëtar i Kryesisë dhe po insistoj me ia dhënë Kujtimit fjalën. Po ia jap Kujtimit.

Në rregull, në rregull, po praktika po them edhe Rregullorja e jep vetëm kryetarëve të grupeve parlamentare e pastaj e jona është të deklarohemi me votim. Fjalën e ka kryeministri Haradinaj njëherë e pastaj shohim.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Edhe një herë, ndoshta nuk kemi qenë të qartë që në nisje të kësaj seance, nga Qeveria, por po dua të ju siguroj kështu.

Kemi një kërkesë te ju, një ligj që e ndërron një gjendje, ta nisni sot, ta kaloni në lexim të parë, ta merrni në shqyrtim, Parlamenti. Nuk mund ta detyrojmë ne Parlamentin që të mos e bëjë një shqyrtim serioz të këtij ligji edhe le t'i marrë ditët që i duhen për ta shqyrtuar seriozisht. Nëse Parlamenti për një arsye sot, cilëndo qoftë, thotë nuk duam në procedurë të shpejtë, nuk duam sot ta nisim këtë ligj, vërtet po e kaloni në ato dinamikat tjera, që janë shumë të ngadalshme dhe që i bëjmë një vakum vetes.

Tani, nuk mendoj që kjo është dëm për Qeverinë, ose për një grup parlamentar, ose për një parti politike, ose për një grup të interesit. Kjo është njëfarë dobësie për të gjithë në këtë vend. Ju kisha lutur pra, si deputetë, merreni në shqyrtim në lexim të parë, merreni kohën që ju vyen ditët, orët e punës, bëni ato ndërhyrje që mendoni se janë të drejta, por mos e humbni këtë mundësi sot, Parlamenti pra le ta marrë në shqyrtim këtë ligj. Kjo është gjendja.

Nëse flasim për marrëdhëniet pozitive-opozitive, e kush çka mund... Shikoni, nuk është e një natyre të tillë kjo materie, kjo temë. Nuk e kemi në atë kontekst, nuk është se po s'e bëri Qeveria këtë ligj ndryshon diçka në veprimtarinë e përditshme javore a mujore a ku ta di unë... nuk është ashtu. Ju lutem, këtë e keni në interes të gjithë. Pra, është një mision i BE-së që ka shkuar, është një situatë që kalon te ne. Kemi pasur në të kaluarën kur kanë kaluar prej OKB-së, e kemi marrë Ministrinë e Drejtësisë, e kemi marrë Ministrinë e Rendit, kemi pasur situata tjera.

Ky është realiteti. Ju lutem, mos e lejoni si Kosovë një situatë të tillë ndoshta vakumi është më i dëmshëm, se keqpërdoret në mënyra të ndryshme, se sa kur i jep bazë ligjore të qartë një situatë e prej këtu deri kur nuk ka ligj, deri kur nuk vendosen ato, ndoshta pikërisht më dëm për shumëkënd është sesa të vihet bazë ligjore.

Ju kisha lutur, shfrytëzoheni këtë mundësi si Parlament, mos e humbni këtë, ju lutem! Pastaj, kur të vijë te substanca të gjithë jepeni kontributin tuaj, ashtu si e vlerësoni më së miri.

KRYESUESI: Në rregull, atëherë po vazhdojmë sipas Rregullores. Deputetët që janë paraqitur për rend dite kanë të drejtë tre minuta të diskutojnë. Fjalën e ka zoti Kujtim Shala.

KUJTIM SHALA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Unë do të flas për procedurë. Besoj që debati që po bëhet këtu është në kundërshtim me Rregulloren, sepse ne e kemi një çështje procedurale, të cilën duhet ta zgjidhim. Pastaj, duhet të kalojmë te çështjet e përmbajtjes së dokumentit.

Kryeministri i Kosovës, zoti Haradinaj, ka kërkuar që Kuvendi të mbajë një seancë të jashtëzakonshme dhe kjo është seanca. Institucionet, mekanizmat e Kuvendit, ose më saktësisht Kryesinë, e implikon vetëm kjo kërkesë. Por, në atë rast Kryesia e Kuvendit është një mekanizëm teknik, sepse kryeministri është një nga institucionet kushtetuese, që ka të drejtë të bëjë një kërkesë të tillë.

Tani, Kryesia ka pasur pak më shumë mundësi që të implikohet, sepse kryeministri nuk e ka kërkuar edhe kohën dhe datën kur do të mbahet seanca e jashtëzakonshme. Domethënë, Kryesia nuk diskuton përmbajtje e lëndë, por vetëm kushte formale të kërkesës. Ndërkaq, ne jemi në një pikë të procedurës për të cilën duhet të deklarohemi dhe duhet me votim, pasi që të marrim qëndrimet e shefave të grupeve parlamentare dhe s'mund të diskutohet përtej kësaj. Cila është ajo kërkesë?

Kryeministri thotë që ky projektligj të shqyrtohet me procedurë të jashtëzakonshme dhe unë ju kërkoj që ta vini në votim, sepse te kjo pikë jemi. Në bazë të votës, pastaj seanca vendos nëse do të shkojmë më tutje, të diskutojmë apo jo. Kjo është kërkesa, nëse kryeministri s'e tërheq në tërësi ne s'mund të diskutojmë pa e zgjidhur këtë çështje. Faleminderit!

KRYESUESI: Këtë e thashë edhe unë, Kujtim, po s'po duan këta. Janë paraqitur, janë edhe gjashtë veta të paraqitur. Ne mund të futemi në votim, por unë thashë që Rregullorja kur është në pyetje diskutimi për rend të ditës ua mundëson deputetëve tre minuta për të diskutuar sa i përket çështjes së rendit të ditës. Dhe, ne jemi në këtë fazë akoma.

Përveç nëse tërhiqen deputetët, të cilët mund të jenë të dobishëm, diskutimet e tyre mund të mos jenë, s'di unë, sepse po bëni... po reagoni pastaj dhe po thoni që po ua shkel dikush të drejtat deputetëve, se kanë të drejtë gjithçka të bëjnë. Atëherë, fjalën e ka zoti Hajdar Beqa. Tre minuta i ke, Hajdar. Edhe flitni, mos diskutoni në diskutimet e të tjerëve, por jepeni mendimin e juaj për çështje.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar ministra,

E mora fjalën edhe pse, realisht kërkuam edhe deputetët tjerë, sepse ndoshta ka qenë mirë në fillim të shkojmë në votim.

Ky shqyrtim i parë i Projektligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, ne e pamë dhe u shpjegua nga të tjerët sesi ka ardhur procedura deri këtu, por një është me rëndësi të thuhet që në Komision për Legjislacion nuk ka pasur ndonjë vullnet që ta futim këtë pikë të rendit të ditës dhe ta shqyrtojmë në parim, edhe pse ndoshta e them me sinqeritet, që kryetarja e komisionit ndoshta me gjet shkresa në korridor të Parlamentit i merr i shti në rend të ditës, kurse atë ditë e shfrytëzoi rastin, që tha edhe zoti Demalija, ne ishim pesë vota kundër dhe pesë për. Kjo e bie krejt poshtë deklaratimet e disa deputetëve të opozitës që me vite të tëra ishin deklaruar që si t'i mbarojë mandati EULEX-it, kurse ne e dimë që ua ka mbaruar këtyre gjyqtarëve më 14 qershor dhe ne nuk po kemi zotësi tash si deputetë, juridike apo profesionale ta marrim këtë mandat dhe t'ua japim gjyqtarëve tanë, që mendoj se duhet ta përfundojnë këtë.

Unë nëse më lejohet dhe nëse më lejon koha do t'i shpjegoj vetëm disa ndryshime që kanë ndodhur. Nuk ka ndonjë ndryshim esencial në ligj që ka ndodhur që e ka prur Ministria e Drejtësisë. Unë e përgëzoj edhe ministrin, po edhe kryeministrin dhe Qeverinë, që shpjeguan që kur ka mundur Qeveria ta votojë në Qeveri, do të thotë ka qenë qershori dhe nuk ka mundur ta sjellë më herët në Kuvend. Ndoshta është menduar dikush që u vazhdon gjyqtarëve të EULEX-it e ndoshta edhe ka pasur biseda në këtë drejtim. Në vijim theksoj disa nga risitë në projektligj për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet që ndërlidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit e që janë ndryshimet përmes të cilave është ristrukturuar dhe forma e funksionimit të brendshëm të gjykatës, duke u shuar kolegjet e specializuara në shkallë të parë dhe kalimin e kompetencave tek një gjyqtar i vetëm. Kjo është një ndryshim që ka ndodhur. Këtë ndryshimin tjetër, po ashtu në mënyrë që Dhoma e Posaçme të jetë në harmoni të plotë me dispozitat e Ligjit për gjykatat. Është shuar pozita e kryetarit të Dhomës së Posaçme, duke i kaluar ato kompetenca kryetarit të Gjykatës Supreme dhe duke njohur pozitën e gjyqtarit mbikëqyrës të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, siç aplikohet në rastet tjera të degëve të gjykatave.

Njëkohësisht, është paraparë harmonizimi i plotë i organizimit të brendshëm me Rregulloren të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, sidomos sa i përket përcaktimit të kompetencave të stafit mbështetës si dhe atij menaxheria drejtues, si dhe administrimit dhe regjistrimit të lëndëve.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Haxhiu prapë e ka kërkuar fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Edhe një herë vetëm shkurtimisht, sepse nuk po dua të ndalem në shumë akuza dhe shpifje të pabaza. Vetëm po dua ta theksoj qëndrimin e Vetëvendosjes. Ne në asnjë mënyrë nuk pranojmë që sot të votohet shqyrtimi i parë, as nuk do të votojmë për shmangie.

Javën e ardhshme si kryetare e komisionit, natyrisht mund ta thërras mbledhjen e komisionit, ku pikë e rendit të ditës në shqyrtim në parim do të jetë ky projektligj dhe pastaj aty në komision do

të mund të vendosim, varësisht se si janë qëndrimet e anëtarëve të komisionit, se kur mund të bëhet shqyrtimi i dytë. Pra, komisioni mund të propozojë edhe shqyrtimin e dytë me mundësinë që kjo do të mund të ndodhte para pushimeve. Pra, ky është qëndrimi i Vetëvendosjes dhe ne po ashtu, propozojmë që kjo çështje të hiqet nga rendi i ditës, rrjedhimisht mocion procedural, që shqyrtimi i projektligjit sot në parim të largohet nga rendi i ditës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Dardan Molliqaj e ka fjalën.

DARDAN MOLLIQAJ: Faleminderit, kryesues!

Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në këtë seancë.

Po më duket se kemi një problem përmbajtjesor dhe nuk e di pse Qeveria është duke insistuar kot, sipas mendimit tim, se një deputet ose një parti politike e mbështet një parim, një ligj me të cilin pajtohet.

Unë po flas në emër të PSD-së. PSD me këtë përmbajtje të ligjit nuk pajtohet dhe rrjedhimisht nuk ka të bëjë vetëm me afatet kohore, por edhe po të ishim në lexim, ose në procedurë të rregullt të ligjit, ne nuk do ta mbështetnim as në parim, sepse dy ndryshimet që u thanë këtu janë thelbësore për neve. Çështja e heqjes së kolegjit dhe çështja e heqjes së kryetarit të Dhomës së Posaçme janë të pakalueshme për ne, kështu që, mbështetje ta zëmë prej PSD-së është kot me pritë, sepse ne nuk e mbështesim as në parim, sikur të ishte edhe me procedurë të rregullt dhe nuk ka kuptim me lyp prej partie, qysh unë po e shoh, të paktën opozitare, të cilat kanë probleme përmbajtjesore me ligjin “jepna mbështetjen për lexim të parë”.

I jepet mbështetje në lexim të parë, kur në parim pajtohesh me ligjin e i ke disa ndryshime, ne në parim për shkak të këtyre ndryshimeve, se më herët u tha këtu që një, ose dy nene, janë më të rëndësishme se krejt, pikërisht këto dyja janë të pakalueshme për ne. Kështu që, unë besoj se jemi duke humbur kohë kot, seriozisht kot, sepse nuk ka vullnet për shmangie të Rregullores për të shkuar qysh ju po kërkon. Nëse ju e ndërroni ligjin në këto dy pika, PSD e rishqyrton, ta zëmë. Nëse jo, kot. Është humbje kohe për krejt neve këtu. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti kryeministër e ka kërkuar fjalën. Zoti Haradinaj.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Edhe njëherë, të nderuar deputetë,

Se u tha që jemi në atë pikën e rendit të ditës, ku duhet ndoshta veç të votohet dhe të vendosim çfarë drejtimi i japim kësaj teme.

Unë nuk e kam kuptuar që ne po ju kërkojmë dakordimin e substancës së ligjit. Ne po ju kërkojmë sot vetëm marrjen në shqyrtim të ligjit. Pra, Dardan, nuk po kërkojmë që ju të bini dakord me përmbajtjen e neneve të këtij ligji. Unë mendoj që gjatë procedurës, gjatë shqyrtimit, nuk e di si do të votoni në substancë, por marrja në shqyrtim, ajo që po ua kërkojmë

mirëkuptimin e juaj, është të paktën kështu besoj unë, ndoshta mund të jem gabim dhe s'i kuptoj procedurat e Parlamentit sa duhet. Ajo që po ua kërkojmë është në vend se një ditë tjetër, cilado qoftë, pas dy-tri javësh a pas disa ditësh, a mund ta merrni sot në shqyrtim. Kjo është kërkesa për ju, të respektuar deputetë.

Nëse s'doni ta merrni sot, vendimi është i juaji. Por, nëse e merrni sot, nuk po jua kërkojmë juve dakordimin në substancë çfarë ua kemi sjellë, po e lëmë në vendimin e juaj, të deputetëve, substancën, se ndoshta keni të drejtë në atë që po thoni, se ky nen, ose ai nen, kjo pikë, ose ajo pikë... por, çështja e kohës është arsyeja pse kemi ardhur te ju kështu. Pse çështja e kohës? Shikoni, ka një datë kur edhe me ligj tani EULEX-i nuk është më në mandatin e mëhershëm. Nga ajo minutë, ose nga ajo kohë janë aktivizuar obligimet për ne. Ne kemi mundur t'i bëjmë disa parapërgatitje përpara se shihet që ky ligj është përgatitur para se me shkua EULEX-i, por megjithatë s'kemi mundur ta fuqizojmë dhe ta sjellim në kohën e caktuar e të krijojmë situata të tjera.

Tani e keni këtu. Ju lus si deputetë, pra nëse e vlerësoni, merreni në shqyrtim tani dhe kur të vijë deri te leximi i radhës, ose votimi i dytë, ose si quhet ai, ju e keni mundësinë vërtet ta trajtoni përmbajtjen. Pra, nuk po insistojmë sot në përmbajtje menjëherë. Pra, nuk po ju themi "veç kështu ligjin". Ndërsa, nëse nuk vendosni kështu edhe varianti që e dha zonja Haxhiu, që komisioni ta marrë në konsideratë prapë çështjen e kohës, pra të fituar në kohë, mos të vonohen procedurat, ne nuk jemi kundër edhe asaj si Qeveri. Pse? Arsyeja është koha, pra nuk është diçka e natyrës tjetër, që po insistojmë te parlamenti. Përmbajtjen, ju lutem, mos lejoni të kalojë një ligj i keq, as ky, as një tjetër.

KRYESUESI: Faleminderit! Dardani ka kundër-replikë.

DARDAN MOLLIQAJ: Puna është kështu, kryeministër!

Ty po të duhet shumica, ose 2/3-at e pranishme për t'u shpallur rendi i ditës dhe arsyeja pse opozita, përkatësisht PSD-ja nuk po e jep këtë, e di se nëse kalon... ata po duan ta shmangin, se pastaj ligji mund të kalojë me shumicë të thjeshtë, që e ka shumicën Qeveria. Opozita, po flas gjithmonë në kuadër të PSD-së, PSD-ja nuk po do t'ia japë këtë mundësi, sepse ka probleme përmbajtjesore me ligjin. Ose, silleni propozimin që dha Lidhja Demokratike e Kosovës, që i ndërroni vetëm çështjen e gjykatësve, ose ndërrojeni përmbajtjesisht ligjin çka po duam edhe ne të tjerët dhe pastaj ua mbështetim edhe në afat kohor. Por, nuk mund që për hir të efikasitetit dhe shpejtësisë së kohës të votojmë diçka që është substanciale, sepse unë, ose PSD, ia hap derën Qeverisë për ta kaluar këtë substancë, me këtë që ju po propozoni si kryeministër.

Kështu që, ju lutem, hiqni dorë prej kësaj...

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti kryeministër e ka fjalën shkurt.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADAINAJ: Ose po e bën me qëllim që të mos kuptohesh, ose nuk jemi kah merremi vesh.

Shiko, duhet të jetë njëra. Ne... ju e nisni sot shqyrtimin, nëse e vendosni si Parlament. Unë nuk e di çka bëni ju me nenet e këtij ligji, nuk jam kah ju them atë pjesë, mos të keqkuptohemi. Ne po u themi, një ligj që një ditë do të vijë në Parlament, mund të jetë sot, mund të jetë pas tri javësh, mund të jetë dikur vonë, a mund ta nisni sot? Sa, kur, qysh e vlerësoni dinamikën pastaj, po fitojmë në kohë me nisje. Nëse arrini ta votoni sot në parim, perfekt. Nëse mbërrini, po ju prapë e shfrytëzoni ligjin, besoj se diskutoni për nenet, e trajtoni përmbajtjen, të paktën kështu po e kuptoj unë, më falni. Ju lutem, ne për këtë punën e EULEX-it edhe marrëdhënien e krijuar me shkuarjen e mandatit, nuk është rezultat i kësaj Qeverie, as nuk e kemi arritur ne këtë farë pune, ky është rezultat i proceseve politike të këtij vendi, ku të gjithë kemi marrë pjesë në mënyra të ndryshme.

Tani, ka ardhur ky moment. Qeveria është, dikush e tha, Kujtimi tha për Kryesinë e Kuvendit, tha ka rol teknik. Qeveria e ka këtë rol, është e detyruar të vijë ta sjellë tek ju transicionin e situatave. Ne kemi bërë detyrën tonë si Qeveri, ua kemi sjellë, me në sjellje po ua lypim edhe a mund sot ta merrni në shqyrtim. EULEX-i ka shkuar, o ju lusim a mund t'ia kalojmë bazës ligjore të Kosovës materien trajtojeni si e trajtoni çdo materie. Kjo është e vërteta e ngjarjes. Nëse Parlamenti thotë "Jo, s'i kemi rendet", ne e respektojmë si Qeveri edhe kaq. Domethënë, s'kemi ku...

KRYESUESI: Faleminderit! Po, zoti ministër ka sqarim shtesë.

MINISTRI ABELARD TAHIRI: Edhe në momentin kur do të vijë në seancë të rregullt, do të vijë përmbajtja e njëjtë prej Qeverisë së Republikës së Kosovës, sepse ne kemi menduar që kjo është përmbajtja më e mirë. Thash prapë, kemi pasur propozime që me u shua krejt, me kalua në gjykata themelore, kemi menduar se është gabim. Ka pasur propozime që ka ekzistuar si një ishull, që s'i ka dhënë përgjegjësi kurrkujt, për atë arsye kjo dhomë tani e tutje do ta ketë një koordinator, por jo kryetar dhome, qysh e ka pasur deri sot, sepse do t'i përgjigjet... mund të mos pajtohem, amendamentohet brenda dy javësh dhe ndryshohet. Besoj që vijnë ndoshta propozime edhe më të mençme prej jush, se sa që kanë ardhur prej nesh. Mirëpo, është me rëndësi që sot të fillojë kjo si procedurë. Sot të shqyrtohet në parim, pastaj ne si ministri bashkë me juve dhe me deputetët tjerë, brenda dy javësh ta trajtojmë, sepse nuk është çështje, është çështje e riorganizimit të një dhome në kuadër të gjykatës supreme dhe s'mundemi, edhe një herë po them, me një nen s'mund t'i zëvendësojmë gjyqtarët e EULEX-it, është problem, sepse ky ligj ka qenë pikërisht pra për ta. Këtu ka qenë përbërja më e madhe e gjyqtarëve të EULEX-it nëpër krejt gjykatat e Kosovës deri në fund, këto dy vjetët e fundit, pra. Dhe ka pasur ndoshta tendencë të vazhdojë edhe pak, derisa të përfundojnë edhe disa procese të privatizimit, mirëpo kemi ardhur në përfundim që më 14 qershor të përfundojë mandati i tyre.

Është me rëndësi edhe për shkak të afateve kohore. Nuk lidhet kjo me punën e Ministrisë së Drejtësisë, kjo lidhet me qindra-milionë euro dhe të punëtorëve. 20%-shi që pesë vjet s'i marrin, që tetë vjet nuk i marrin. Këto janë procese domethënë që mendoj se të gjithë ju, edhe ministria, edhe ju si deputetë, sot do t'u ndihmoni pra edhe atyre gjyqtarëve, edhe atyre të rinjve, edhe punëtorëve, edhe kreditorëve, që t'i realizojnë interesat e veta.

Nuk ka kurrfarë interesi Qeveria në këtë aspekt, se s'jemi as aksionarë, s'jemi pjesë e saj, ne nuk jemi pjesë e Këshillit Gjyqësor, është në pavarësinë e plotë të Këshillit Gjyqësor t'i caktojë gjyqtarët, t'i caktojë panelet, pastaj edhe kjo dhomë të japë përgjegjësi, të ketë llogaridhënie më të madhe karshi kryetarit të Gjykatës Supreme dhe Gjykatës Supreme. Pra, për riorganizimin ne mund të flasim. Është me rëndësi që sot kaloi në parim, dy javë t'i kemi kohë komisioni së bashku me ministrinë ta rishikojë edhe një herë riorganizimin dhe pastaj, brenda muajit korrik ta përfundojmë këtë çështje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Unë ju kisha lutur që të kalojmë në votim, më mirë është se të zgjatemi tani secili po ka diçka të re këtu dhe në fund votimi e përcakton. Po ua jap edhe nga një anëtarit të grupeve parlamentare dhe po e mbyllim këtë çështje, çështjen e diskutimeve sa i përket kësaj. Paraqituni me... votimi i përcakton, votoni kundër a pro, është çështje e juaja. Fjalën e ka Ahmet Isufi.

AHMET ISUFI: Faleminderit, kryesues!

I nderuar kryeministër,

Kabinet Qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ne të gjithë po pajtohemi që është një projektligj me rëndësi të veçantë dhe për atë pikërisht Qeveria e ka ofruar propozimin për seancë të jashtëzakonshme. Kryesia e ka aprovuar që të shkojmë në seancë të jashtëzakonshme, prandaj konsideroj se duhet ta kryejmë këtë çështje procedurale, e cila lejon mundësinë që në fazën e amendamentimit të bëhet shqyrtimi dhe të ndryshohet projektligji në elemente, të cilat edhe po flasim këtu.

Nuk e di pse ka hezitim, derisa EULEX-i e ka kryer mandatin dhe kërkohet që të zëvendësohet Dhoma e Posaçme me gjykatës vendorë. Kjo do të ishte përkundrazi edhe për opozitën një entuziazëm, që të kalojmë sa më shpejt në një fazë kur institucionet e vendit funksionojnë me gjyqtarët e vet. Prandaj, kisha thënë që çështja procedurale le të kryhet. Është faza e amendamentimit, deputetët le të kontribuojnë, le t'i bëjnë amendamentet, në fund të fundit edhe në leximin e dytë mund të jenë kundër. Pse tash ta pengojmë derisa po kërkohet një përsheptim i procedurës, që mundëson funksionalizimin e Gjykatës Supreme duke pasur parasysh krejt problemet që u përmendën, edhe lidhur me punëtorët, edhe lidhur me funksionimin e procesit të privatizimit.

Prandaj, kërkoj që të hidhet në votim dhe të votojmë pro, në mënyrë që të lihet faza e amendamentimit, edhe opozita, edhe pozita, mund t'i japim amendamentet e tyre. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Milaim Zeka e ka fjalën.

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryetar!

Në radhë të parë dëshiroj të them që ky, ose kjo është iniciativa më e guximshme e Qeverisë në mandatin e vet, për ta sjellë një propozim në ligj, i cili rregullon çështjen më tragjike të të kaluarës së Kosovës, kur 21 300 lëndë janë të pashqyrtuara, si faj i drejtpërdrejtë i gjyqtarëve të EULEX-it. Bunkeri i krimit dhe i korrupsionit ka qëndruar pikërisht në Dhomën e Posaçme dhe pikërisht me fajin e EULEX-it. Prandaj, në mënyrë absolute nuk po e kuptoj qëndrimin e opozitës, që prapë është demagogji, në një anë duam t'i mbrojmë të drejtat e punëtorëve, në anën tjetër bllokohet një procedurë, jemi duke folur për procedura.

Unë po e bëj një qartësim, me sa unë po e kuptoj kryeministrin, ai e ka një hall kryesor të përshpejtojë shqyrtimi i këtyre lëndëve, t'u jepen kompetenca gjykatave tona t'i shqyrtojnë këto lëndë, sepse çdo gjë është bllokuar.

E tha ministri i Drejtësisë që nuk jemi aksionarë, ai mund të flasë për vete, se ka mundësi që deputetët këtu janë aksionarë në faqe të zeza e në lëndë që janë në Dhomë të Posaçme. Pasi të fillojë 'të hyjë' tërfurku atje, do të shohësh ti, ministër, kush është aksionar dhe kush po i pengon ligjet, se këtu ne folëm për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve, po Zoti e di se ku i kemi rrënjët në privatizim, në devijimin e privatizimit, në krejt këto lëndë, do të dalin edhe shumë deputetë të përzier.

Sa për fund, dëshiroj t'i sqaroj publikut, që ne po i japim kaq peshë gjoja se po marrka kohë puna e shqyrtimit të një ligji. Ky debat po u përngjan këngëtareve tona që ulen në studio dhe thonë: "Jam duke u marrë me një projekt shumë të rëndësishëm", që një vit duke e bërë një videoklip. Një videoklip xhirohet dy ditë, e montohet tri ditë, e bëjnë pesë ditë në 365 ditë.

Çdo ligj, çdo ligj që unë e kam lexuar sa jam deputet në këtë Parlament, po të ketë vullnet nga deputetët e Parlamentit të Kosovës mund të shikohet, mund të analizohet vetëm për katër ditë. Krejt ligjet na i bien ndërkombëtarë të gatuar, ne nuk po prodhojmë ligje, ne veç i lexojmë, e japim nga një mendim nganjëherë që s'ka fare të bëjë me ligjet, veç ashtu flasim paushall.

Prandaj, mbi bazën e kësaj kisha kërkuar që ta votojmë përshpejtimin e këtij ligji, në mënyrë që të fitojnë kohë punëtorët, qytetarët edhe gjykatat t'i shqyrtojnë ato lëndë, që janë 21 mijë e 300. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Osmani.

VJOSA OSMANI: Faleminderit!

Në radhë të parë, zoti kryesues, ka qenë tepër e rëndësishme, meqenëse po diskutojmë një kërkesë për shmangie, të lexohej përmbajtja e asaj kërkesë, sepse kërkesa për shmangie mund të ketë nuanca të ndryshme, mund të kërkohet shmangia nga procedurat dhe gjithçka të kryhet brenda 24 orësh. Mund të kërkohet të mos u lejohet deputetëve fare të bëjnë amendamente, siç ka ndodhur në të kaluarën, është votuar dhe pastaj s'u është lejuar fare deputetëve të amendamentojnë.

Mund të kërkohet trajtimi brenda muajit korrik, ne nuk po e dimë çka përmban ajo kërkesë.

Nga fillimi i kësaj seance deri tani u ndryshuan qëndrimet disa herë. Në fillim thuhej që po kërkohet të trajtohet paradite dhe pasdite të nxirret në votim edhe shqyrtimi i dytë, rrjedhimisht gjithçka do të përfundonte brenda ditës, ndoshta mundet kryetarja e Komisionit për Legjislacion të na sqarojë çka saktësisht po kërkohet të shmangemi nga procedura. Kërkesa e kryeministrit thjesht thotë të shmangemi, por jo çfarë brenda çfarë periudhe mund të kryhet gjithçka.

E dyta, të sqarohet edhe një herë që ky nuk është plotësim-ndryshim i ligjit aktual, është një ligj komplet i ri, i cili në qoftë se lexohet memorandumit shpjegues dhe po ashtu përmbajtja e tij, sqarohet që këtu nuk kemi të bëjmë vetëm me përfundimin e mandatit të gjyqtarëve të EULEX-it, por edhe me shumë çështje të tjera, duke përfshirë në tërësi rregullat e procedurës, në bazë të së cilës punojnë ata gjyqtarë. Dhe po ashtu sqarohet që ky ligj i trajton të gjitha problemet, të cilat i ka pasur në punën e vet kjo Dhomë e Posaçme përgjatë viteve.

Pra, në qoftë se po i trajtuara të gjitha ato probleme, ndoshta ministri i Drejtësisë mund të na tregojë sa i ka marrë kohë Ministrisë së Drejtësisë hartimi i këtij projektligji dhe kjo do të tregonte se sa po ashtu i duhet përafërsisht edhe Kuvendit të Kosovës, e jo të kërkohet kjo punë të përfundojë brenda 24 orëve.

Tani po thuhet që mesazhi i keq po i jepet BE-së, mirëpo në fakt vetë BE-ja ka kërkuar që ne të mos i trajtojmë ligjet në procedura të përshpejtuara.

Po ashtu, sa i përket përfundimit të mandatit të EULEX-të, edhe në qoftë se vetëm ajo çështje të trajtohej, sepse ministri i Drejtësisë e di që ka mundur në bazë të parimit "mutatis mutandis" gjithçka të përfundojë me një nen dhe po ashtu të ndryshojë kudo që është përmendur EULEX-si, të zëvendësohej me nene të tjera.

Mirëpo një gjë dua ta përmend, presidenti i vendit ka nënshkruar shkëmbim notash, shkëmbim letrat me Bashkimin Evropian për një mandat të ri të EULEX-it, ai dokument që ka karakterin e marrëveshjes ndërkombëtare, sipas Konventës së Vjenës për Traktate, nuk u është shpërndarë deputetëve, së paku jo në bazë të kontakteve të mia me administratën dhe kolegët e LDK-së.

Pra, ne ende nuk e dimë cili është ai mandat i ri i EULEX-it, a ka kompetenca ekzekutive apo vetëm këshillëdhënëse? Neve na duhet ai dokument që e ka karakterin e marrëveshjes para se ta votojmë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Haradinaj e ka fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: U ngritën shumë tema nga zonja Osmani.

Vërtet në kërkesë arsyeja pse kërkohet një procedurë e përsheptuar është të fitohet në kohë. Ajo që u mundova ta them në fillim nuk po kërkojmë procedurën e përsheptuar që t'ju vidhet lënda, ne të sjellim një ligj e t'ju nxjerrim para aktit të kryer, nuk e kemi aty hallin. Vetëm situata reale, në vend të një procedure që zgjat dhe kushedi kur vjen në rend të ditës, a kishit mundur të nisni shqyrtimin e këtij ligji sot, kjo është logjika. Ndoshta nuk e kemi shkruar saktë, kërkojmë falje, po kjo është arsyeja.

Tjetra, ndërrimi i letrave për mandatin e EULEX-it, ajo është temë në vete. Parlamenti ka të drejtë të kërkojë krejt materien dhe është mirë ta ketë në kohë atë, edhe Qeveria, edhe institucionet e tjera.

Ne e kemi përcjellë këtë proces të diskutimit me EULEX-in, pra me shefin e EULEX-in, Papadopoulos, por kjo ka ndodhur në nivele të tjera, mendoj që është diçka shumë e drejtë që ju ta keni krejt materien si Parlament.

Edhe një herë ju lus që kërkesën ta kuptoni prej Qeverisë, nuk është halli t'ju nxjerrim para aktit të kryer për shkak të përmbajtjes së ligjit, po është halli vetëm të shfrytëzohet një mundësi ligjore, procedurale, që ky ligj të hyjë në rend tani për shkak se, vërtet, shikoni, nuk është mirë ku po e biem veten në situata, del një ambasador e thotë t'i votojmë gjyqtarët se e kemi vakumin e Gjykatës Kushtetuese ose nesër të na thotë dikush i keni kërkuar kompetencat si Kosovë, qe, ju na keni kritikuar neve se i kemi lënë 21 mijë lëndë, e ju nuk jeni në gjendje as ta aktivizoni veten.

Çka të bëjmë, ky është realiteti ynë. Në këtë realitet ju e keni vendimin tuaj, ju kërkoj falje, do të lirohem për pak minuta, por do të kthehem prapë në seancë. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Tahiri, edhe një herë!

MINISTRI ABELARD TAHIRI: E nderuar zonja Osmani,
E thashë që ky projektligj është krahasuar gjatë asaj periudhe ku e kemi negociuar edhe mandatin e EULEX-it.

E para, nuk është mirë të manipuloni, me koncept dokument, me të gjitha kanë qenë dy muaj e gjysmë, koncept dokumenti, i kemi respektuar afatet, konsultimet paraprake, konsultimet me publikun dhe, pra, janë 40 faqe. Janë 146 faqe, të cilat janë në tri gjuhë, në gjuhën serbe, angleze dhe në gjuhën shqipe. 40 faqe nuk besoj që iu kishte dashur shumë kohë secilit deputet t'i trajtojë, edhe para se të vinim sot në mëngjes t'i trajtojë.

Nuk po flasim për sistemin gjyqësor në tërësi, po flasim për një Dhomë të Posaçme në kuadër të Gjykatës Supreme, e cila po mban qindra miliona euro pengë, të cilën tashmë po e përfundojnë mandatin shtatë gjyqtarë të EULEX-it, po ndryshohet riorganizimi i kësaj Dhome.

Po them, sot ta shqyrtojmë në parim dhe, ndoshta na vijnë ide më të mira prej jush, ta shohim riorganizimin e kësaj Dhome, nuk kemi kurrfarë pune ne tani e tutje, prej momentit kur kalon ky ligj në Qeveri, kjo është çështje e Këshillit Gjyqësor tani e tutje, hajde ta përcaktojmë strukturën e kësaj Dhome, së bashku, ndoshta e rrisim numrin e gjyqtarë, 20 janë.

Ne e kemi ndryshuar edhe panelin, i kemi pasur tri panele në shkallën e parë, një panel në shkallën e dytë, domethënë 20 gjyqtarë gjithsej dhe kryetari 21. Ta ndryshojmë, ndoshta mendojmë që duhen 40, e ndryshojmë strukturën ose të mos e caktojmë numrin hiç, t'ia lëmë Gjykatës Supreme.

Mirëpo, unë mendoj që është tepër e rëndësime për të gjithë ata punëtorë, për kreditorët, për politikën në përgjithësi, për Këshillin Gjyqësor ne sot ta trajtojmë këtë çështje, janë 40 faqe projektligj, si në gjuhën shqipe, në gjuhën angleze e në gjuhën serbe. Normalisht sot partneri ynë i koalicionit që i ka ngrirë pozitat nuk merr pjesë, Lista serbe, sepse janë kundër përfundimit të mandatit të EULEX-it, të gjyqtarëve. Mirëpo kjo duhet të ndodhë.

Po them prapë, po e përsëris për të tretën herë, me një nen nuk mund t'i zëvendësojmë gjyqtarët e EULEX-it, është e pamundur, sepse i ke pasur në dy panele, domethënë specifikohet qartë në secilën pikë të ndryshimeve, edhe në të kaluarën shtojca s'ka qenë pjesë e këtij projektligji. Tashmë edhe shtojcën e ka bërë më voluminoze, sepse edhe shtojca është pjesë e këtij projektligji.

Unë nuk do ta politizoj shumë. Mendoj që është kërkesa e arsyeshme, të gjitha deri tash i thamë. Unë konsideroj që mund të vijnë ide edhe më të mira gjatë dy javëve në komision. Të hyjmë sot ta diskutojmë në parim, ta votojmë në parim dhe brenda dy jave i jepni idetë tuaja për riorganizimin e kësaj Dhome dhe vazhdojmë më tutje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Me cilin e ke replikë, me të dytë përnjëherë. Replikë ka zonja Osmani.

VJOSA OSMANI: Po, prapë as ju, as kryeministri nuk sqaruat çka është kërkesa juaj për shmangie? A doni thjesht që brenda dy javësh të trajtohet në tërësi projektligji? Në qoftë se është ashtu, pse ju ka tek sot ne ta trajtojmë në shqyrtim të parë? Ne mund të lejojmë komisionin më 5 korrik ose 6 sa ishte ta kryejë në shqyrtim të parë, deri më 15 korrik ta kryejmë në shqyrtim të dytë. Po ndoshta edhe nuk ka kjo lidhje fort me procedura, por ka me ato qindra milionat që i përmende në prezantimin tënd paraparak! Pra, nuk mund të thoni që nuk keni mundur t'i zëvendësoni çështjet lidhur me zëvendësimin e gjyqtarëve të EULEX-it me 3-4 nene, sepse këtë e kemi bërë me qindra herë në të kaluarën.

Ju e dini fort mirë, keni qenë i involvuar në procesin e përfundimit të pavarësisë së mbikëqyrur, qysh kjo çështje me një ligj janë ndryshuar 21 ligje të tjera duke u bazua në parimin juridik që e përmenda më herët, pra ku një ndryshim vlen në të njëjtën mënyrë edhe për ndryshme të tjera, poenta është kjo.

Le të mblidhet komisioni për lexim të parë pas një jave, e pastaj deputetët në ndërkohë mund ta shqyrtojnë ligjin. Në qoftë se juve u janë dashur dy muaj e gjysmë, cili është problemi që të lejohet Kuvendi në procedura të rregullta të determinojë brenda këtij muaji të përfundojë gjithçka.

Po e përsëris, jo duke mbajtur dokumente esenciale që kanë të bëjnë me mandatin e ri të EULEX-it fshehtë prej këtij Kuvendi. Ne së pari duhet parë dokumentin që është nënshkruar prej presidentit dhe të shihet çfarë roli është paraparë aty për EULEX-in tash e tutje, kë e këshillojnë, çfarë roli kanë në panelin e Gjykatës Kushtetuese që ka të bëjë me Gjykatën Speciale? A do të kenë ndonjë rol monitorues në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme? Vetëm kur t'i shohim ato, mund ta dimë saktësisht se si do të votojmë për ligjet, të cilat janë prodhim i asaj marrëveshjeje ndërkombëtare.

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë ka zoti ministër Tahiri!

MINISTRI ABELARD TAHIRI: Me këtë plotësim-ndryshim jemi munduar t'i evitojmë të gjitha problemet që kanë ndodhur për tërë këto vite në kuadër të kësaj Dhome të Posaçme.

Është projektligj i ri, sepse kemi pasur katër plotësim-ndryshime të mëhershme të këtij projektligji, edhe një herë nuk kemi dashur të vijë në të njëjtën formë, është e vërtetë, me përfundimin e pavarësisë mbikëqyrëse ka ndodhur një gjë e tillë. Mirëpo është esenciale zëvendësimi i gjyqtarëve të EULEX-it, sepse Dhoma paralizohet, nuk mund të vazhdojë tutje.

Po ajo çka ka qenë e rëndësishme, e dyta, është riorganizimi i Dhomës, prapë po e quaj, e thashë edhe më herët, riorganizimi që ne kemi ide të ndryshme, të kundërta.

Neve na ka marrë kohë dy muaj e gjysmë për faktin sepse ka qenë debat i ashpër, kemi parë gjyqtarë që kanë menduar që kjo duhet të shkojë, edhe sot e mbrojnë fuqishëm idenë e tyre që kjo duhet të shkojë në Gjykatën Themelore, duhet të jetë departament i Gjykatës Themelore dhe nuk duhet të ekzistojë në këtë formë.

Në anën tjetër, shumica e të tjerëve, edhe ekspertët e ministrisë, edhe të gjyqtarëve në kuadër të Këshillit Gjyqësor e kanë kundërshtuar një gjë të tillë, sepse ne...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër. Replikë ka edhe zonja Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Po, e para, vetëm ta sqaroj këtë që e pyeti zonja Osmani sa i përket shmangies.

Neve vetëm na ka ardhur një letër, ku nga ana e kryeministrit është kërkuar seancë e jashtëzakonshme për ta shqyrtuar me procedurë të përshpejtuar projektligjin, aq. Dhe, është e vërtetë ajo që përmendi zonja Osmani, ka pasur shumë raste në të kaluarën kur deputetëve iu ka pamundësuar të bëjnë amendamente dhe ky projektligj, natyrisht që nuk do ta ketë përkrahjen e Vetëvendosjes në parim, kjo as nuk vihet në dyshim, sepse ka probleme të shumta që do të mund të ndryshoheshin nëse kalojnë amendamentet tona në seancë parlamentare pastaj në shqyrtim të dytë.

Unë e thashë qëndrimin e Vetëvendosjes më herët dhe natyrisht që nuk tërhiqemi nga ai, por kjo që ka të bëjë me EULEX-in.

Më 26 qershor ne e kemi parë një deklaratë të Këshillit të Bashkimit Evropian, e cila deklaratë thekson që Këshilli i Bashkimit Evropian mirëpret marrëveshjen për zgjatjen e mandatit të EULEX-it deri në vitin 2020, çka nënkupton është e shpjeguar më tutje, që kjo nënkupton që Kosova duhet të vazhdojë bashkëpunimin ngushtë me EULEX-në realisht deri në vitin 2020.

Pra, zonja Osmani po kërkon qartë dhe natyrisht që dokumenti që Hashim Thaçi po e mban të fshehur duhet të bëhet publik për deputetët e Kuvendit, që ka të bëjë me mandatin e EULEX-it. Unë të paktën mendova që ministri i Drejtësisë do të na thotë këtu, cili do të jetë mandati i EULEX-it tani e tutje? Për shkak se Këshilli i Bashkimit Evropian e mirëpret zgjatjen e mandatit të EULEX-it deri në vitin 2020, cila është e vërteta? Faleminderit!

KRYESUESI: Kundër-replikë, zoti Tahiri.

MINISTRI ABELARD TAHIRI: Është viti i parë pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës ku më nuk do të ketë kompetenca ekzekutive misioni ndërkombëtar në kuadër të institucioneve tona, sidomos në kuadër të sundimit të ligjit.

Pra, edhe ky është projektligji i parë që kemi iniciuar pas përfundimit të mandatit të EULEX-it.

Ne do të kemi një mekanizëm përcjellës në numër shumë më të vogël nga Bashkimi Evropian ashtu siç e ka Shqipëria, EURAL-5, ashtu siç e kanë edhe vendet e tjera të rajonit që mbikëqyren nga Bashkimi Evropian për hapat e tyre të mëtutjeshëm drejt integritetit të BE-së.

Normalisht do të na vëzhgojnë, do të na monitorojnë, do të jetë një mision këshillëdhënës, mirëpo nuk do të ketë kompetenca ekzekutive më brenda institucioneve të Kosovës, siç i kemi pasur deri më sot. Ajo është çështje tjetër, flasim në seancë edhe për Gjykatën Speciale.

Ndërsa, mandati i EULEX-it në kuadër të institucioneve tona përfundon, ka përfunduar më 14 qershor dhe ky ligj që nuk po e përkrahni sot, është pikërisht iniciativa...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Memli Krasniqi.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, zoti kryesues!

Realisht kjo seancë sot, për fat të keq, përkundër që ishte për ta trajtuar proceduralisht një kërkesë të kryeministrit dhe Qeverisë, u shndërrua në diçka krejt tjetër, qysh edhe po ndodh shpesh.

Në fund, këtu ishte diçka e qartë, nëse na ka përcjellë ndokush besoj që ka mundur të kuptojë cila është situata.

Kërkesa e Qeverisë është: të fillojë trajtimi sot dhe jo, ta zëmë më 8 ose 9 korrik. Pra, ka të bëjë me një kërkesë për 10-12 ditë t'i kursejmë, meqenëse ky Kuvend shkon në pushim.

Dhe, ne që po e mbështesim procedurën, kemi këtë qasje: të kalojë sot në lexim të parë, t'u jepet kohë deputetëve të bëjnë ndryshime, siç propozova unë, një javë, nëse donë dy javë, po hajde edhe tri javë, po të mos të gënjen askush e të thotë se janë kërkuar 24 orë, se asnjëri këtu nuk kërkoi të kryhen dy lexime për një ditë.

Ne kërkua ta shtimë në procedurë të përshpejtuar, pra të mos pritet të vijë në komision më 6 apo me 9 në seanca ku di unë, po të fillojë sot, jo të kryhet sot. Le të kryhet kurdo që është i zoti komisioni ta kryejë!

Dhe, e dyta, çka po kuptohet është një banalitet ndërmjet kërkesës të mbrohen të drejtat e punëtorëve, të ndryshohet situata dhe vazhdimi të bllokadës.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme është ndër instancat më jofunksionale dhe më joefikase që e ka pasur Republika e Kosovës që sa vjet.

Sot na ka ardhur një ligj që mundohet ta funksionalizojë, të njëjtit deputetë që e kritikojnë, thonë po vazhdojmë me situatën qysh është! Se kërkesa për të shkuar në procedura siç po thonë, është të vazhdojë kjo situatë. Derisa s'ka ndryshim të ligjit, vazhdon situata aktuale, përveç me një dallim.

Tash as formalisht nuk mund të krijohen panelet, sepse ka përfunduar mandati i EULEX-it dhe sot kjo qasje bllokues e pamundëson ndryshimin e situatës post EULEX, sepse s'lejon emërimin e gjykatësve vendorë t'i zëvendësojnë ata të EULEX-it.

Po e përfundoj, sepse veç jemi duke u përsëritur. Jemi në një situatë mes vazhdimi të situatës aktuale me një bllokadë shtesë dhe daljes prej situatës përmes ndryshimit të legjislacionit.

Të gjitha palët po thonë që po donë ta ndryshojnë legjislacionin, dallimi i neve që po e mbështesim procedurën e përshpejtuar është që ne po kërkojmë që kjo punë të kryhet gjatë muajit korrik, e të tjerët po thonë 'këqyrim', që i bie në fund të këtij viti. Pra, edhe gjashtë muaj të bllokohen punëtorët që të mos kenë as të drejtë të kërkojnë 20%-shin e tyre, e le më diçka tjetër!

Unë ju thashë ta caktojmë datën 19 korrik - 26 korrik, po mos thoni 'hajt se këqyrim'.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Sami Kurteshi e ka fjalën.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderura kolege dhe kolegë deputetë,

Unë e di që s'doni të dëgjoni dhe s'jeni hiç të interesuar të dëgjoni, mirëpo ne po diskutojmë për norma dhe për ligj që megjithatë ka qenë thelbi dhe baza e plaçkitjes së pasurisë publike në Republikën e Kosovës tash e 20 vjet. Pikërisht me këto ligje në formë të tillë që po kërkojnë t'i kalojnë brenda 24 orëve, është vjedhur pasuria publike e Republikës së Kosovës, e punëtorëve të Republikës së Kosovës, për të cilët po qajnë tani.

Për 10, 15 ditë, një apo dy muaj, nuk varfërohen punëtorët e Republikës së Kosovës ashtu siç po kërkohet tani me demagogji, por varfërohen duke lënë vrima nëpër ligjet tona, mandej duke thënë i ka fajet ligji dhe Dhoma e Posaçme. Zoti ministër, nuk e keni gjetur mundësinë që ta sillni një dokument të na tregoni se cilat ndryshime i keni bërë. Asnjë deputetë këtu nuk i dinë cilat ndryshime. Asnjë! As ata që janë në krye atje. Unë kam kërkuar me kohë, thirrni ministrin, le të na i sjellë ndryshimet, ta dimë çfarë ndryshimesh ka bërë. Ju e keni sjellë një ligj të ri, pse nëse janë veç 2-3 nene nuk po thoni është plotësim-ndryshim. Ne kemi kontratë të re ndërmjet Presidentit edhe EULEX-it ose Bashkimit Evropian, e nuk e dimë. Ne sot dhe të gjithë kolegët dhe koleget deputete, nuk e dinë për çka kanë për të votuar në parim. Nuk e dinë! Le të dalë dikush e le të thotë “unë e di për çka po votoj”, por unë po e them po votojmë për një ligj që ka për t’i vënë bazat e plaçkitjes së pasurisë kombëtare dhe publike në Republikën e Kosovës në vitet e ardhshme.

Prandaj, pranojeni propozimin që Komisioni dhe deputetët të kenë kohë ta shqyrtojnë ligjin në parim, të kenë pajtime dhe të mospajtime dhe të shkojmë, pse jo, edhe me procedurë edhe më të përshpejtuar, edhe në leximin e dytë, por jo brenda 24 orëve, jo brenda 5 ditëve, por brenda muajit korrik. Kjo është kërkesa dhe kjo është oferta më e mirë që mund të bëhet. Nuk duhet të votohet një ligj që ka për t’i vënë bazat e plaçkitjes së pasurisë publike në Kosovë brenda disa ditëve ose disa orëve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Tahiri e ka kërkuar fjalën për replikë.

MINISTRI ABELARD TAHIRI: Nuk e di a po e bën me qëllim apo s’je duke e ditur. Nuk është ligj që e përcakton mandatin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, por është ligj i cili përcakton organizimin e Dhomës së Posaçme, që i rregullon kontestimet përbrenda. Pra, ju lus që sot ta votojmë në parim, sepse e kemi me rëndësi, janë 40 faqe, është memorandum i shpjegues që e kemi sjellë, nuk kemi të bëjmë me një projektligj me 160 faqe qysh po thoni, sepse është përkthimi në tri gjuhë. Sot ta shqyrtojmë, ta kalojmë në parim, ose ta rrëzoni me votë, qysh të doni. Është çështje e juaja, është çështje e deputetëve, mirëpo është me rëndësi që sot ta trajtojmë këtë temë.

Pastaj, në lexim të dytë, kurdo që ju mendoni, sado kohë që ju duhet, 2 javë, 3 javë, ne mund ta bëjmë një gjë të tillë. Kjo është çështje e Gjyqësorit tani e tutje, nuk është çështje e Qeverisë. Po them, mos e ngatërro çështjen e mandatit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit me Dhomën e Posaçme.

KRYESUESI: Kundër-replikë, zoti Kurteshi!

SAMI KURTESHI: Zoti ministër,

Sa për informatën tënde, unë nuk manipuloj asnjëherë, por e kam lexuar ligjin dhe e kam analizuar shumë mirë dhe e di për çka po flas. Nëse manipuloni ju, pse nuk i keni sjellë ndryshimet në letër? Hajde, unë dua prej një ministri të një Qeverie transparencë të plotë, këtu keni diskutuar, me kë keni diskutuar? Ju lutem, lërimi këto manipulime, ky është ligji bazë që vendos për të drejtat e njerëzve që u merret pasuria publike, kurse ajo Agjencia e Privatizimit veç i cakton normat, thotë ty takon kaq, e ty kaq. E në këtë ligj thuhet qysh, ta shet ai shefi atje, ti ke për ta pranuar. Ta shet Ballkanin e Suharekës 1 milion e 300 mijë euro, nga ato merreni 20% nëse doni, nëse s'doni humbni te shtëpia, kurse ai tjetri i shtet 30 arë brenda asaj sipërfaqe 1 milionë e 700 mijë. Këtu janë bërë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Qysh po e shoh unë, ka qenë shumë më mirë ta fillojmë seancën, të diskutojmë për ligjin, t'i bëjmë amendamentet, e deri tash do ta kishim kryer. Fjalën e ka zoti Dardan Molliqaj.

DARDAN MOLLIQAJ: Faleminderit!

Përpjekja e ministrit dhe e Qeverisë sot për ta bindur Parlamentin është e drejtë prej anës së tyre, absolutisht, proceduralisht është në rregull. Por, po ashtu, ky debat nuk kishte për të zgjatur kaq shumë ministër sikur t'i kishit votat. Praktikisht Qeveria në të cilën ti je pjesë nuk i ka votat. E para s'i ka votat për shmangie, meqë i duhen 2/3 e pranishme, e dyta, qysh unë po e shoh, s'i keni votat as shumicën për shkak që një grup parlamentar për interesa të ndryshme politike nuk e voton në asnjë rrethanë. Nëse po doni që ta votoni ligjin, po i kundërpërgjigjem kryetarit të Grupit Parlamentar të PDK-së, po caktojani edhe ju një datë, cilindo, s'po duam ta shtyjme në pafundësi, por nëse i doni votat tona, duhet t'i merrni parasysh mendimet tona. Nëse s'i doni mendimet tona për ligjin, për përmbajtjen po flas, në rregull, vazhdoni me votat që i keni.

Tash, ju më thoni ne e bëjmë këtë në lexim të dytë, perspektiva jonë është që ne nuk hyjmë fare në lexim të dytë nëse ju nuk keni vullnet për t'u marrë vesh paraprakisht. Nëse doni të merremi vesh paraprakisht me votat e partive opozitare, duhet ta merrni mendimin për përmbajtje. Po ju them publikisht, që unë po e shoh që refuzimi sot është duke ndodhur për shkak se kemi dallime përmbajtjesore joprocedurale, edhe ne të gjithë po më duket jemi gati të votojmë nëse do të ishim pajtuar me ligjin, por në fund po flas në emër të PSD-së. PSD-ja nuk e voton ligjin as sot, as më 6, as më 7 me këtë përmbajtje. E voton nesër ligjin nëse dy çështje kryesore adresohen sipas asaj që ne po mendojmë dhe ky në fund është prapë mendimi ynë, nuk është mendimi që duhet të imponohet, por nuk mund të votojmë diçka përkundër asaj që besojmë.

Sa i përket urgjencës, mos u bëni hipokritë, sepse e kemi organin më të lartë të drejtësisë - Gjykatën Kushtetuese pa kuorum për shkak të shumicës, se nuk jeni marrë veshë për gjyqtarë

dhe ne e dimë marrëveshjen. Keni pasur marrëveshje edhe me një parti opozitare dhe është rasti, që është qesharak, të njëjtit njerëz që ky Kuvend i ka refuzuar, komisioni prapë i ka vlerësuar dhe prapë na vijnë në votim. Cili është kuptimi që kandidatët për Gjykatën Kushtetuese e kanë marrë verdiktin, vlerësimin e Kuvendit dhe të njëjtit janë kthyer prapë. A e dini pse janë kthyer, ministër? Se e keni bërë marrëveshjen prapë dhe dihet kush ka për të shkuar në Gjykatën Kushtetuese.

Pra, mos u shtirni që e keni veç efikasitetin. Nëse doni të merremi vesh për përmbajtjen i keni edhe votat, nëse s' doni që të merreni vesh për përmbajtjen hidheni në votim dhe e shihni sa e keni fuqinë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Tahiri e ka fjalën.

MINISTRI ABELARD TAHIRI: Që 10 muaj prej 16 projektligjeve që i kam kaluar në Kuvend të Kosovës, 15 prej tyre kanë qenë me përkrahjen e opozitës, për ç'gjë ju falënderoj shumë. Edhe për këtë projektligj, unë jam shumë i interesuar të ju dëgjua gjithë juve dhe ta shoh thashë tri herë po e përsëris, mund të ketë edhe ide më të mira për riorganizimin e kësaj, mund të jepni argument pse duhet të vazhdojë kryetari i Dhomës, e jo koordinatori qysh e kemi parë ne të arsyeshme. Po, unë po them, kemi vullnet edhe duam që bashkërisht ne ta vendosim bazën e kësaj Dhome, sepse nuk është çështje që ndërlidhet me funksionimin e Qeverisë. Është komplet çështje e Gjyqësorit dhe dua të ju dëgjoj të gjithëve dhe bashkërisht nëse vërtet vjen në lexim të dytë e sjellim edhe amendamentin që ti po e propozon, e hedhim, e votojmë dhe e përkrahim. Nuk është çështje e funksionimit të Qeverisë kjo.

Unë për atë arsye po them, çështja e Gjykatës Kushtetuese nuk bie në kompetencë timen si ministri se e kisha shtyrë përpara vetë, po kjo është çështje që ndërlidhet me mandatin tim si ministër i Drejtësisë për funksionimin pra të Dhomës së Posaçme në kuadër të Gjykatës Supreme. Për atë arsye po them, hajde te caktojmë, te votojmë këtë projektligj dhe pastaj ulemi dhe unë po të siguroj ty dhe të gjithë deputetët tjerë që jam i gatshëm të ulem për secilin nen, ta flasim edhe për riorganizimin e Dhomës, edhe për numrin e gjyqtarëve, edhe për mandatin e tyre, ndoshta edhe për një kohë kur duhet të përfundojë. Sa më shpejt, sa më efikase të jetë kjo Dhomë, ne aq më shpejt do ta përmbyllim procesin e privatizimit në Kosovë.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Molliqaj ka kundër-replikë.

DARDAN MOLLIQAJ: Shumë shkurt!

Po e bëjmë ndryshe për t'u siguruar që fjala juaj si ministër dhe e shumicës parlamentare qëndron. Po biem në dakordancë paraprakisht për përmbajtjen e ligjit dhe pastaj krejt partitë opozitare votojnë edhe për shmangie, edhe për procedurë të përshpejtuar.

Pra, në momentin që partitë opozitare janë dakord me përmbajtjen brenda një dite mund ta bëjmë. Arsyeja pse krejt jemi duke kundërshtuar është se kemi mospajtime, e unë nuk mund t'i besoj kësaj Qeverie se faktin që ti ke disponim të diskutosh, kjo nuk më garanton që ke për ta përfshirë mendimin tonë dhe ti s'ke nevojë ta përfshish kur s'pajtohesh po ashtu. Nëse dëshiron ta çojmë përpara, nisi konsultimet me partitë opozitare, përfshirë përmbajtjen e kërkesave të tyre dhe pastaj hajde edhe me procedurë të përshpejtuar e kalojmë ligjin sa më shpejtë që është e mundur. Kjo është rruga që ne propozojmë.

KRYESUESI: Faleminderit! Janë edhe dy diskutues në emër të grupeve që realisht janë paraqitur. Është Teuta Haxhiu, që do t'ia jap fjalën, dhe zoti Sherifi, të tjerët janë...

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar!
Më në fund, e kisha të drejtën sikur gjithë të tjerët.

KRYESUESI: S'ke të drejtë...

E kam të drejtën dhe s'e ke të drejtën të ma mohosh. Së pari, të gjithë diskutuesit këtu në Kuvend, në qoftë se e marrim transkriptin dhe e shohim, sidomos dy fjalët që u thanë në fillim që projektligji në fjalë i ka 140 apo 150, doli që nuk është e vërtetë. A është kështu, apo jo?

Domethënë, nuk i paska 140 faqe, por i paska diku rreth 40 faqe. A është kjo e vërtetë? Kjo po tregon edhe një herë sa e keni lexuar ju profesionistët e kësaj fushe. E dyta, për të gjithë deputetët, e sheh faqen e fundit në tri gjuhët, prandaj kështu e lexoni, një po, një jo, për të gjithë deputetët që e kanë pasur materialin më 22 qershor, të gjithë jemi ftuar me një rend dite, të gjithë e kemi pasur një rend dite, që seanca fillon në orën 10:00 dhe rendi i ditës është vetëm me një pikë, e që shkruan: Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Dhomat e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Ky është materiali që u është shpërndarë të gjithë deputetëve, prandaj lojërat dhe ato çka po thuhet këtu sinqerisht, sado që unë nuk jam në fushën e legjislacionit, megjithatë po më befasojnë si dokumente. Më 22 qershor u është shpërndarë të gjithë deputetëve i njëjti material. Në qoftë se ka diçka tjetër që i është shpërndarë dikujt një material, e dikujt tjetër një material tjetër, është mirë ta dimë.

Krejt çka unë erdha në përfundim si joprofesioniste, po del që nuk e kanë lexuar, se s'po e dinë sa faqe i ka, nuk po e kuptoj a janë për atë që EULEX-i ta përfundojë mandatin, është pikëpyetje për mua, ende s'kuptova, a janë për ta përfunduar mandatin, apo jo. Dhe, e treta, për ata qytetarë që po na dëgjojnë për dy e sa orë që po i humbim këtu, deputetët punën e tyre e kanë pikërisht ndërmjet dy leximeve, nga leximi në parim e deri te leximi i dytë kur të vijë në seancë, aty është puna e deputetit, por aty nuk ka shumë herë media dhe aty nuk mund të themi gjithçka që na teket "hajt pak" sikur këtu. Aty e kemi obligim, jemi të obliguar dhe është detyrë e jona për të dhënë propozime profesionale, për t'i ndryshuar, e kemi të drejtën në bazë të Rregullores së

Kuvendit, na jep atë mundësi Rregullorja e Kuvendit që t'i japim ne propozimet tona dhe t'i sjellim në Kuvend. Hajdeni sillini njëherë propozimet, e ta shohim atëherë në Kuvend nëse po i votojmë, a nuk po i votojmë.

Sot po luani lojë, e kam thënë lojë, por lojë me të cilën po e demantoni dhe vetveten, duke qenë ama jo lexues, por abuzues edhe me fjalën e juaj. Pra, jashtë Rregullores po tentoni të luani me Kuvendin, me të gjithë deputetët që vërtet...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Zoti Sherifi e ka fjalën.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, zoti kryesues!

Mendoj që kemi hyrë në një rreth të mbyllur, rreth vicioz, nga i cili nuk po mund të dalim. Pozicioni i mazhorancës është i qartë, kërkon që sot të fillojë trajtimi në parim i këtij ligji. Pozicioni i partive opozitare është i qartë, votat e përcaktojnë këtë çështje. Tash, meqë kemi nevojë për votat e opozitës, lus deputetët e mazhorancës të jenë pak më të kujdesshëm. Mos i hidhëroni, seriozisht po them. Tash nuk kemi nevojë të përplasemi me ata për të cilët kemi nevojë, për votën e tyre, që të fillojë seanca, duke filluar prej Memlit, e Bilallit, e Teutës, që po të përmend Teutë, e të gjithëve me radhë kemi nevojë për mbështetje. Unë mendoj që këtu pati propozime konstruktive edhe nga opozita, që thonë “hajde ta caktojmë një datë kur po e kalojmë në lexim të parë, sa ditë po i futim në mes, 15, 20 a 25, për ta trajtuar përmbajtjen dhe të vijmë pastaj në seancë dhe ta kalojmë ligjin në lexim të dytë”.

Nuk është se nuk ka propozime nga opozita. Pra, ministër, merreni rolin që e keni tani, mos na e lini neve se lehtë është për të ardhur e për të thënë “shihe, ne e kemi sjellë ligjin këtu, tash ju deputetët merruni vesh”. Po, a po e sheh që s’po mund të merremi vesh. Merreni rolin që e keni, dilni me një propozim konkret përtej kësaj që keni ardhur, përtej propozimit konkret me të cilin keni ardhur, sepse kemi ngecur në të ashtuquajturën “fazë procedurale” dhe veç po sillemi në të njëjtën vend dhe nuk po mund të dalim e të ecim përpara. Rrafsh dy orë jemi duke biseduar për këtë. Pra, pretekst e kemi procedurën, ndërsa të gjithë jemi futur në përmbajtje, të gjithë po bisedojmë për përmbajtjen dhe nga të gjithë ka tendencë që të keqpërdoret ky ligj, duke filluar nga opozita, duke thënë që ky ligj shkel të drejtat e punëtorëve, nuk mbron të drejtat e punëtorëve, e deri te mazhoranca, që thotë jo ju jeni kundër përfundimit të mandatit të EULEX-it. Prandaj, t’i lëmë këto goditjet e ulëta nga të dyja anët në momentin kur kemi nevojë që të dy palët së bashku të fillojmë shqyrtimin dhe në fund krejt kjo të përfundojë me kalimin e ligjit së bashku në këtë Parlament të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: I fundit është Islam Pacolli dhe pastaj do të kërkoj një mendim të Komisionit për Legjislacion dhe të ministrit, i cili do të deklarohet për kërkesën e vet që e ka në raport me deputetët. Zoti Pacolli, i ke edhe dy minuta e gjysmë.

ISLAM PACOLLI: Përshëndetje, nënkryetar!

Përshëndes Kabinetin qeveritar, edhe pse është vetëm një ministër,

Kolegë të nderuar,

Medie,

Unë e kam cekur edhe një herë më herët që kur ka nevojë për diçka që është çështje e rëndësishme, kur të mblihet Kryesia duhet t'i ftojë edhe ata, të cilët nuk kanë grup parlamentar, një.

E dyta, Parlamenti nuk ka ofruar kushte të barabarta edhe për ata që nuk kanë grup parlamentar. Ku t'i shqyrtojmë ne këto dokumente? Prandaj, mendoj që është e rëndësishme që ne të jemi unikë, të bashkëpunojmë, t'i zgjidhim çështjet për arsye që në fund kërkohet vota e secilit. Ne jemi për përkrahje dhe t'i çojmë këto dokumente përpara, por ju lus që të krijohen kushte të barabarta dhe prandaj t'i analizojmë në mënyrën më të mirën të mundshme dhe ta gjejmë unifikimin e trajtimit të këtyre ligjeve, të cilat janë të rëndësishme për Republikën e Kosovës, të mos i marrim ad hoc pa shqyrtim fare e të sillen përpara.

Prandaj, ju lutem nënkryetar dhe sekretar që të na i plotësoni kushtet brenda Parlamentit të Kosovës për trajtimin e dokumenteve, të cilat na takojnë edhe me ligj të Republikës së Kosovës për deputetët. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën përfundimtare sa i përket kësaj, në emër të Komisionit, e ka zonja Haxhiu, dhe pastaj ministri dhe e mbyllim më, pas tij më nuk ka diskutim!

ALBULENA HAXHIU: Po e them mendimin e grupit, domethënë të kryetares së Komisionit, sepse për të pasur qëndrim të komisionit duhet të mblihdemi dhe natyrisht që nuk e kam qëndrimin e komisionit. Unë po e them qëndrimin e grupit dhe të kryetares.

Unë thashë që nuk e thërras mbledhjen e komisionit pa qenë data 6 korrik. Atëherë plotësohen kushtet, e merr komisioni, unë edhe po të dua në atë kohë s'mund ta ndaloj, për shkak se e kërkon Rregullorja. Dhe, edhe një herë, ne po ju themi që jeni Qeveri e pakicës, ju po thoni "jo, s'jemi e pakicës", tash nuk po mund ta kaloni as një ligj e lëre më t'i keni 2/3-at për shmangie. Prandaj, a po mateni në Kuvend të Kosovës, sepse është e qartë që nuk e keni shumicën, e keni pakicën, andaj duhet të largoheni. Pikë!

KRYESUESI: Faleminderit! Unë ju kisha lutur të mos më keqpërdorni. Fjalën e ka ministri Tahiri dhe debati është i mbyllur. Më s'e merr fjalën kurrkush, veç votimin e bëjmë.

MINISTRI ABELARD TAHIRI: Unë propozoj që ta kemi një pauzë pesë minutash bashkë me komisionin, me shefat e grupeve parlamentare ta trajtojmë dhe të fillojmë seancën pastaj.

Sa për sqarim për deputetët, unë kam kërkuar momentin që kemi miratuar në Qeveri, të kam dërguar kërkesë me shkrim për t'u takuar me ty, e para si kryetare e komisionit, pastaj me informua edhe komisionin se për çka bëhet fjalë. Mirëpo, normalisht, ti e ke agjendën shumë të ngarkuar, s'ke pasur kohë as të përgjigjesh në atë kërkesën tonë edhe... jo, jo, e kam lënë hapësirën edhe për të nesërmen për të të informuar saktësisht çka po duam të bëjmë, edhe ty, edhe komisionin, por e ke agjendën të ngarkuar ti, s'mundesh.

KRYESUESI: Faleminderit! Tani, a doni t'ia ktheni përgjigjen me po, ose jo, kryetarët e grupeve parlamentare kërkesës së ministrit. A dëshiron Avdullah të flasësh? Jo, nuk... I dinë kryetarët të drejtat e veta dhe në rregull, atëherë ne e kemi kuorumin e mjaftueshëm për votim. E dini që në sallë janë 75 deputetë, e dini që 2/3-at e deputetëve prezentë vendosin nëse mund të kalojmë sot këtë ligj, nëse nuk votojnë 2/3-at për atëherë nuk kalon dhe vazhdojmë me seancën, pikat që i kemi pasur të pakryera.

Edhe një herë po e deklaroj, kërkohet deklarimi me votim për pauzë një orë, për ta ngarkuar Komisionin Funkcional për Legjislacion për shqyrtimin e projektligjit në parim.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Unë nuk mund t'i ndryshoj përgjegjësitë e mia. Kështu është propozimi edhe i Qeverisë, kështu është bërë skenari dhe unë nuk mund të filloj shqyrtimin e ligjit, pa e dhënë mendimin komisioni.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim! Çka...?

(Ndërprerje e incizimit)

Edhe një herë, të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë, uluni. Kemi detyrim kushtetues për të votuar.

Ju lus që të uleni në vendet e juaja. Edhe një herë po ju informoj, që kërkesa është që të mblidhet komisioni dhe duhet të votojmë për të marrë pauzë njëorëshe, me qëllim që komisioni të vendosë. Nëse nuk e shqyrton komisioni ne nuk mund ta fusim çështjen, ligjin në fjalë, në shqyrtim. Ju lus, uluni! Uluni, sepse do të bëhet votimi. Në qoftë se ju nuk votoni, edhe unë e kam shumë të lehtë ta qes veç në anën tjetër këtë ligj dhe nuk kam ndonjë problem, as me ju, as me ligjin.

Atëherë, lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, Votojmë tash për pauzë dhe shqyrtim nga komisioni të ligjit.

Regjia, votojmë tash!

Është e qartë, deputetët nuk duan të votojnë. Unë e shtyj në afat të pakufizuar. Kur të vendosë Kryesia, e sjell. Vazhdojmë me seancën. Në orën 13:30 e jap pauzën.

Ani, uluni edhe një herë votoni bre, s'e kam parë. Votoni bre njëherë e po shkojmë në pauzë se s'bëhet kiameti.

(Ndërprerje e incizimit)

Faleminderit! Ju lus, e kemi një marrëveshje xhentëlmënesh ndërmjet grupeve parlamentare dhe ministrit, me qëllim që të mos detyrohemi ta tërheqim ligjin, ose ta kundërshtojmë. Si procedurë, si proces, ne duhet ta kryejmë. Unë ia jap fjalën ministrit, meqenëse është propozues dhe besoj që...

MINISTRI ABELARD TAHIRI: Faleminderit për përkrahjen dhe për konstruktivitetin!

Pra, propozojmë që në seancën e radhës të jetë pjesë e rendit të ditës dhe u dakorduar që brenda muajit korrik së bashku ministria me komisionin ta bëjë amendamentimin dhe kemi gatishmërinë dhe vullnetin, që çdo çështje që vjen e që e ka përkrahjen e shumicës, ta përkrahim, sepse është në interes të vendit t'i trajtojmë këto çështje, nuk është në interes as të pozitës, as të opozitës. Pra, në seancën e radhës do të takohemi. Para seancës ne kemi vullnet, si ministri, të takohemi edhe me Komisionin për Legjislacion edhe me deputetët veç e veç me i trajtua para se me i sjellë. Domethënë, në qoftë se ka nevojë të ndryshojë ky propozim që e kemi sjellë dhe në seancën e radhës, takohemi. Mirëpo, kjo të përfundojë brenda korrikut. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! A ka dikush kundër këtij propozimi? Nuk ka. Atëherë, konsideroj që propozimi është i pranueshëm për të gjitha grupet parlamentare dhe miratohet.

Data e saktë kur duhet të mbahet mbledhja është data 9 korrik, pastaj në lexim të dytë e bëjmë vendimin e përbashkët në Kryesi e në komisione. Në rregull është.

Tani, a dëshironi të shkojmë në pauzë, apo dëshironi ta vazhdojmë? Atëherë, në orën 14:00 fillojmë me seancën e rregullt. Faleminderit!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*